

With funding from

 Austrian  
Development  
Cooperation



# ANALIZA VJETORE E PERFORMANCËS 2023

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE  
FALAS



ADRESA: RR.“JORDAN MISJA”, GODINA NR.3, TIRANË

# MINISTRIA E DREJTËSISË DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

## ANALIZA VJETORE E PERFORMANCËS VITI 2023

Në mbështetje të shkronjës “b” të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”, u hartua raportimi për vitin 2023.

Ky raport përmbledh detyrimet funksionale dhe obligimet që rrjedhin nga ligji nr. 111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”, politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë, dokumentat strategjikë në të cilat institucioni është i përfshirë, si dhe prioritetet dhe objektivat e Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas për vitin 2024, të ndara respektivisht sipas kërreëve.

### Qendrat e Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore



- Tropojë  
Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë
- Shkodër  
Rr.Don Bosko, pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm,Shkodër
- Pukë  
Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë
- Kukës  
Rr.Eksod 99, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kukës
- Lezhë  
Pranë Bashkisë Lezhë
- Dibër  
Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër
- Mat  
Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat
- Kurbín  
Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbín
- Durrës  
Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës
- Kavajë  
Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë
- Tiranë  
Ministria e Drejtësisë
- Elbasan  
Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan
- Lushnjë  
Rruga Bajram Haxhiu, pranë Bashkisë Lushnjë
- Pogradec  
Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec
- Fier  
Lagjia ‘Kastriot’, Rr ‘Ramiz Aranitasi’, Këshilli i Qarkut, Kati i I, Fier
- Berat  
Zyra me nje ndalese, Bashkia Berat
- Korçë  
Pranë ish Gjykatës së Apelit Korçë
- Vlorë  
Pranë Bashkisë Vlorë
- Përmet  
Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet
- Gjirokastër  
Blv. 18 shtatori, brenda Pallatit të Sportit, Gjirokastër

## Tabela e Përmbajtjes

<b>1. Funksonimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas .....</b>	<b>5</b>
1.1 Propozimi për ndryshimin e strukturës së DNJF me qëllim shtimin e numrit të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.....	6
<b>2. Ndhma Juridike Parësore .....</b>	<b>10</b>
2.1 Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore. ....	10
2.1.1 Kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të 2 nga 10 Qendrat e hapura me mbështetjen e UNDP.....	12
2.1.2 Hapja e 6 qendrave të reja të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore. ....	12
2.1.3 Zhvendosja e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec. ....	14
2.1.4 Zhvendosja e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë.....	15
2.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me qëllim ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore. ....	15
2.2.1 Angazhimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në kuadër të zhvillimit të trajnimeve për studentët. ....	16
2.2.2 Zhvillimi i praktikave 2 mujore të punës pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë, Durrës dhe Shkodër. ....	17
2.3 Financimi nga Buxheti i Shtetit i Organizatave Jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë. ....	17
2.4 Të dhënat statistikore për vitin 2023, ndihma juridike parësore. ....	19
2.4.1 Kategoritë e veçanta të përcaktuara në Ligj, përfutjes të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, viti 2023. ....	23
<b>3. Ndhma juridike dytësore .....</b>	<b>24</b>
3.1 Procesi i lidhjes së kontratave me avokatët .....	24
3.2 Trajnimi i avokatëve pjesë e listës. ....	25
3.3 Ecuria e vendimeve për pranimin e ndihmës dytësore. ....	25
3.4 Caktimi i Avokatëve .....	29
3.5 Një konkluzion i të dhënave statistikore me një qasje krahasuese .....	30
3.6 Problematika lidhur me ndihmën juridike dytësore.....	31
<b>4. Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore dhe dytësore.....</b>	<b>32</b>
4.1 Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore (Janar-Dhjetor 2023).....	32
4.1.1 Analizë e raporteve të monitorimit të kryera në Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore. ....	33
4.1.2 Ecuria e kryerjes së monitorimeve të qendrave.....	34
4.1.3 Konkluzione dhe Rekomandime nga Monitorimet e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore. ....	36
4.2 Monitorimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.....	37
<b>5. Ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e ndihmës juridike .....</b>	<b>39</b>
5.1 Zhvillimi dhe pjesëmarrja në takime/aktivitete ndërgjegjësuëse. ....	39
5.1.1 Zhvillimi dhe pjesëmarrja e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në aktivitete/ takime. ....	39
5.1.2 Zhvillimi dhe pjesëmarrja e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në aktivitete/ takime. ....	42

5.2 Zhvillimi i intervistave televizive në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike, edukimit ligjor të publikut.....	60
5.3 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet në nivel qendror dhe vendor si dhe me organizata jofitimprurëse që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve. ....	63
<b>6. Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore .....</b>	<b>65</b>
6.1 Bashkëpunimi me OSCE (Trajnimi i ofruesve të ndihmës juridike parësore).....	65
<b>7. Kontribute dhe raportime të DNJF-së në kuadër të proceseve strategjike.....</b>	<b>66</b>
<b>8. Raportime ndërkombëtare .....</b>	<b>73</b>
<b>9. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetase (UNDP/OSFA/CLE).....</b>	<b>74</b>
9.1 Kërkesë për mbështetje me qëllim forcimin e sistemit të ndihmës juridike falas. ....	74
<b>10. Prokurimet.....</b>	<b>75</b>
<b>11. Të dhëna buxhetore .....</b>	<b>78</b>
<b>12. Arritjet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për vitin 2023/ Vështrim krahasimor, vitet 2021 – 2023.....</b>	<b>81</b>
<b>13. Plani i Punës Janar- Dhjetor 2024.....</b>	<b>88</b>
13.1 Risi për vitin 2024.....	104

## 1. Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, organizimi i brendshëm i së cilës fillimisht është miratuar nga Kryeministri, me Urdhër nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë Ndhmës Juridike Falas”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Falë punës dhe arritjeve përgjatë viteve 2019-2023, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka kaluar si Institucion qendror i grupit të parë, zyrtarizuar me Vendimin nr.443, datë 29.6.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave” “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.

Përgjatë vitit 2023, është bërë i mundur ndryshimi i strukturës me Urdhër nr.21, datë 01.03.2023, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas” dhe struktura e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas u rrit me 14 punonjës, nga 25 në 39 punonjës në total.

Gjithashtu, në mbështetje të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.310, datë 02.05.2023 “Për miratimin dhe kalimin nën administrimin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tropojë, Mat, Pukë, Kurbin, Kavajë, Përmet”, u miratua hapja e 6 (gjashtë) Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore me mbështetje nga Buxheti i Shtetit.

Në përfundim të pozicionit të ristrukturimit dhe hapjes së 6 qendrave të reja, pozicionet e mbetura vakante për vitin 2023, janë **gjithsej 11 vende vakante ( 5 Sh.Civil + 6 K.Punës)**, përkatësisht:

### Shërbim Civil

- Përgjegjës sektori - në Sektorin e Administrimit të Ofruesve të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore. Krijuar si vend vakant për shkak të shtimit në strukturë. Është dërguar në DAP për shpallje me shkresën nr.1214 prot, datë 01.06.2023.
- Përgjegjës sektori - në Sektorin e Administrimit dhe Vlerësimit të Dosjeve të Ofruesve të Ndhmës Juridike Dytësore, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Standardeve dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Dytësore. Krijuar si vend vakant për shkak të shtimit në strukturë. Është dërguar në DAP për shpallje me shkresën nr.1546 prot, datë 24.07.2023.
- Specialist- Drejtoria Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore. Është dërguar në DAP për shpallje me shkresën Nr.1253 prot, datë 06.06.2023.
- Specialist (Financë Buxhet) - Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështëse. Krijuar si vend vakant për shkak të shtimit në strukturë. Është dërguar në DAP për shpallje me shkresën nr.1215 prot, datë 01.06.2023. Është shpallur nga DAP me shpalljen 4811 dhe është ende në proces rekrutimi.
- Specialist IT- Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështëse. Krijuar si vend vakant për shkak të shtimit në strukturë. Është dërguar në DAP për shpallje me shkresën nr.1716 prot,

datë 01.09.2023. Është shpallur nga DAP me shpalljen 4911 dhe është ende në proces rekrutimi.

### **Kod Pune**

- **6 Specialist** pranë Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore (*Jurist-Qendra*).

#### **1.1 Propozimi për ndryshimin e strukturës së DNJF me qëllim shtimin e numrit të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore**

Konsolidimi i sistemit të ndihmës juridike parësore por edhe puna intensive e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në promovimin e sistemit ka passjellë një rritje progresive të numrit të qytetarëve përfitues nga shërbimet të ndihmës juridike parësore nga **23 raste për vitin 2019**, në **4191 raste për vitin 2020**, në **8153 raste për vitin 2021**, në **7616 raste për vitin 2022** si dhe **7008 raste për vitin 2023: Total: 26,991 raste**.

Gjithashtu, për herë të parë në rajon u mundësua një platformë online e dedikuar shërbimeve ligjore falas (*juristionline.al*), si dhe vendosja në dispozicion i numrit të gjelbër 08001010, nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas edhe në kushtet e pandemisë.

**Sa i përket ndihmës juridike dytësore**, kanë rezultuar në listën e avokatëve ofrues të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, **60 avokatë në vitin 2019; 70 avokatë në vitin 2020; 124 avokatë në vitin 2021; 157 avokatë në vitin 2022**, ndërsa në **vitin 2023 janë kontraktuar 159 avokatë**. Rritja progresive e interesit të avokatëve për t'u bërë pjesë e ndihmës juridike dytësore është një tregues i qartë që sistemi i ndihmës juridike dytësore është funksional dhe i gatshëm për qytetarët në nevojë.

Ky fakt rezulton dhe nga numri i kërkesave për ndihmë juridike dytësore (*përfaqësim me avokat të garantuar nga shteti në gjykatë*). Vetëm përgjatë vitit 2021, kanë përfituar ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore 671 persona (*nga 849 vendime gjyqësore në total*), një **7-fishim i rasteve të trajtuara krahasimisht me vitin 2020 (181 raste në total)**. Për vitin 2022, janë administruar **1030 vendime** duke e çuar numrin në total në **2060 vendime**, ndërsa për vitin 2023, janë administruar **773 vendime** duke e çuar numrin në total në **2833 vendime**.

Numri i vendimeve gjyqësore të administruara për ndihmë juridike dytësore, përkthehet drejtëpërdrejt në kosto për buxhetin e shtetit, si dhe në rritjen e numrit të përfaqësimeve gjyqësore të cilat duhet të mbikëqyren për nga cilësia e shërbimit, nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike, pjesë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Nuk mund të mos përmendim gjithashtu dhe angazhimin e Drejtorisë në kuadër të **Strategjive dhe Raportimeve Ndërkombëtare** në kushtet kur Aksesi në Drejtësi është një komponent shumë i rëndësishëm i sanksionuar nga shumë akte ndërkombëtare. Përmendim këtu angazhimin në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP); Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND); Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK); Strategjinë e Drejtësisë për të

Miturit (SDM); Planin e Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (OGP); Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, Strategjinë ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit për periudhën 2024-2030; Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, etj.

Sa më sipër, pavarësisht faktit se Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është institucion i krijuar rishtazi, efektiviteti dhe produktiviteti i skemës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti ka patur një impakt mëse pozitiv në kuadër të përmbushjes së misionit madhor “Garantimit të aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët si një e drejtë themelore me karakter kushtetues”.

Proçeset e sipërcituara të punës tregojnë qartazi një ngarkesë të lartë të punës, ngarkesë e cila nuk është në raport me numrin e punonjësve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Si rrjedhojë, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në punë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, me shkresën me nr.1757 prot., datë 20.09.2022, si dhe shkresën me nr.162 prot., datë 18.01.2023, ka propozuar ndryshimin e strukturës së DNJF-së duke shtuar numrin e punonjësve nga 25 punonjës në 39 punonjës në total.

Arsyet e kërkesës për ndryshimin e Strukturës së DNJF-së:

1. Me Vendim nr.443, datë 29.06.2022, pika 1/3 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave”, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas falë punës dhe arritjeve përgjatë viteve 2019-2022, ka kaluar si Institucion qendror të grupit të parë, në varësi të Ministrave të Linjës;
2. Zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit (*Marrëveshja Shkurt 2022-Shkurt 2023*) me nr.763/1 prot., datë 15.02.2022 midis UNDP dhe Ministrisë së Drejtësisë ku ndërmerret angazhimi jo vetëm për vijimin e mbështetjes së qendrave aktuale, por edhe për hapjen e 4 (*katër*) Qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore, me kushtin që MD të kalojë si pjesë të strukturës së DNJF-së 2 (*dy*) nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore të hapura më mbështetjen e UNDP dhe në vijim për kalimin rast pas rasti të qendrave të tjera;
3. Harta e re gjyqësore (*Këshilli miratoi raportin vlerësues përfundimtar të Grupit Ndërinstitucional të Punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave*) parashikon 12 gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe vetëm 1 gjykatë apeli për juridiksionin e përgjithshëm dhe 1 për atë administrativ. Mbyllja e gjykatave në rrethe, sjell nevojën që qytetarët në këto rrethe të kenë paqartësi për procedurat që duhet të ndjekin, si dhe institucionet ku duhet të drejtohen. Si rrjedhojë, me qëllim garantimin e aksesit në drejtësi lind nevoja që në ambientet e gjykatave që do të mbyllen të jetë funksionale 1 (një) qendër e shërbimit të ndihmës juridike parësore për të informuar të gjithë individët të cilët kërkojnë një informacion mbi procedurat dhe institucionet ku duhet të drejtohen për zgjidhjen e problematikës së tyre;
4. Nga analiza vjetore e bërë përgjatë vitit 2021, vëmë re një shtim të rasteve si për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore ashtu edhe për numrin e vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike dytësore. Ky numër në rritje do të passjellë nevojën e shtimit të stafit pranë

strukturave të DNJF-së për qëllim vlerësimin e shërbimit të ofruar nga avokatët dhe ekspertët dhe deri në procesin e likuidimit të tyre;

5. Rritja e numrit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore në Tiranë dhe në rrethe sjell nevojën e rritjes së stafit të DNJF për mbikëqyrjen në terren të cilësisë së shërbimit;
6. Rritja e numrit të Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore sjell nevojën për monitorimin e vazhdueshëm të prezencës së punonjësve si dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit nga qendra kundrejt qytetarëve duke krijuar indikatorë të matshëm mbi cilësinë e ofrimit të shërbimit dhe promovimin në vijimësi të shërbimit me qëllim që shërbimi të jetë i njohur dhe efektiv për të gjithë qytetarët.

Përmes ndryshimit të Urdhrit të Kryeministrit nr.59 datë 25.03. 2019, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”* nëpërmjet riorganizimit të strukturës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, me qëllim administrimin e stafit në funksion të arritjes së objektivave, u propozua krijimi i 2 sektorëve brenda një Drejtorie me shtesë në pozicionin *“Përgjegjës Sektori”*, shtesë punonjës për Qendrat e Ndihmës Juridike Falas si dhe rishpërndarjen e re të detyrave funksionale dhe përgjegjësi të punonjësve.

Me Urdhrin nr.21, datë 01.03.2023 të Kryeministrit *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”* u miratua struktura dhe organika e sipërcituar dhe Urdhri i Kryeministrit nr.59 datë 25.03.2019 *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”*, i ndryshuar, shfuqizohet.

Struktura e miratuar së fundmi është ndryshuar me Urdhrin nr.2 datë 05.01.2024, *“Për një ndryshim në Urdhrin nr.21, datë 01.03.2023 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas” si më poshtë vijon:*

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
<b>1. DREJTOR I PËRGJITHSHËM</b>	I-4	<b>1</b>
<hr/>		
<b>2. DREJTORIA E ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE</b>		<b>24</b>
DREJTOR	II-1	1
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË OFRUESVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE		
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-3	1
SPECIALIST (Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore)	IV-2	18
SPECIALIST-JURIST	IV-2	2
SEKTORI I ZBATIMIT TË POLITIKAVE, PROJEKTEVE DHE STRATEGJIVE		
SPECIALIST-JURIST	IV-2	2



**3. DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË  
NDIHMËS DYTËSORE** **7**

DREJTOR	II-1	1
SEKTORI I ADMINISTRIMIT DHE VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE		
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-3	1
SPECIALIST-JURIST	IV-2	3
SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE DHE DYTËSORE		
SPECIALIST-JURIST	IV-2	2

---

**4. DREJTORIA E FINANCËS, ARKIVIT DHE SHËRBIMEVE  
MBËSHTËTËSE** **7**

DREJTOR	II-2	1
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS		
SPECIALIST-FINANCË/BUXHET	IV-2	2
SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTËTËSE DHE ARKIVIT		
SPECIALIST-BURIME NJERËZORE	IV-2	1
SPECIALIST-ARKIV/PROTOKOLLI	IV-2	1
SPECIALIST-IT	IV-2	1
MAGAZINIER	Klasa	1
<b>TOTAL</b>		<b>39</b>

## 2. Ndihma Juridike Parësore

Bazuar në nenin 13 të ligjit 111/2017, ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;
- b) organizatat jofitimprurëse të autorizuara;
- c) klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Administrimi dhe promovimi i sistemit të ndihmës juridike parësore ka qenë një ndër prioritet kyçe të DNJF. Përgjatë kësaj periudhe DNJF ka mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore, si dhe me organizatat ndërkombëtare partnere si UNDP; OSFA; CLE apo OSBE me qëllim nxitjen e sistemit të ndihmës juridike parësore.

### 2.1 Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Bazuar në kompetencën e caktuar në nenin 8, pika gj) DNJF administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.

Në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF ka vijuar me procedurat e hapjes së qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytete të cilat, kanë më shumë nevoja për këtë natyrë shërbimi.

- ❖ *Për vitin 2023, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas administron **20 (njëzetë) Qendra** të shërbimit të ndihmës juridike parësore si vijon: **8 (tetë) Qendra** të shërbimit të ndihmës juridike parësore financohen nga **UNDP/ADC** përkatësisht në qytetin e Lezhës, Pogradecit, Vlorës, Dibrës, Kukësit, Korçës, Beratit dhe Elbasanit, kurse **12 (dymbëdhjetë) qendra** si: Tirana, Lushnja, Durrësi, Shkodra, Tropoja, Përmeti, Puka, Mati, Kavaja, Kurbini, Gjirokastra dhe Fieri (**financohen nga buxheti i shtetit**), sipas tabelës si vijon:*

Qendra	Hapur/Rivitalizuar	Vendndodhja	Mbështetës
Tiranë	Korrik 2021	Ministria e Drejtësisë	Buxhet Shteti
Durrës	Dhjetor 2020-UNDP Korrik 2022- Buxhet Shteti	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	Buxhet Shteti
Fier	Shkurt 2021	Këshilli i Qarkut Fier (zhvendosur nga ADISA Fier)	Buxhet Shteti
Lezhë	Dhjetor 2020	Bashkia Lezhë	UNDP/ADC
Lushnje	Shtator 2020	Bashkia Lushnjë	Buxhet Shteti
Gjirokastrë	Dhjetor 2020	Pallati i Sportit, Bashkia Gjirokastrë (zhvendosur nga ADISA Gjirokastrë)	Buxhet Shteti

Shkodër	Shkurt 2021-UNDP Korrik 2022- Buxhet Shteti	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër	Buxhet Shteti
Pogradec	Tetor 2020	Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec	UNDP/ADC
Vlorë	Mars 2021	Bashkia Vlorë	UNDP/ADC
Dibër	Shkurt 2021	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër	UNDP/ADC
Elbasan	Korrik 2022	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	UNDP/ADC
Berat	Korrik 2022	Bashkia Berat	UNDP/ADC
Kukës	Nëntor 2022	Bashkia Kukës	UNDP/ADC
Korçë	Dhjetor 2022	Pranë ish Gjykatës së Apelit Korçë	UNDP/ADC
Përmet	Korrik 2023	Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet	Buxhet Shteti
Tropojë	Korrik 2023	Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë	Buxhet Shteti
Mat	Korrik 2023	Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat	Buxhet Shteti
Pukë	Korrik 2023	Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë	Buxhet Shteti
Kurbin	Gusht 2023	Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin	Buxhet Shteti
Kavajë	Gusht 2023	Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë	Buxhet Shteti

***Referuar prioriteteve të Ministrisë së Drejtësisë dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Punës të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas për vitin 2023, u bë e mundur hapja e 6 (gjashtë) Qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tropojë, Mat, Pukë, Kurbin, Kavajë dhe Përmet.***

Hapja e 6 (gjashtë) Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në këto qytete është dakordësuar si objektiv i Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, si rrjedhojë e riorganizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”.

***Përgjatë vitit 2023 është bërë i mundur kalimi nën administrim si pjesë e strukturës së institucionit të 2 qendrave hapura me mbështetjen e UNDP në Fier dhe Gjirokastrë (në kuadër të marrëveshjes mes Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).***

Nga ana e DNJF janë ndërmarrë masat për lidhjet e marrëveshjeve “Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundërshpërblim për hapjen e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore” me institucionet ku janë vendosur këto qendra si dhe rekrutimit të punonjësve me trajnim të posaçëm, sipas praktikës së konsoliduar të ndjekur përgjatë vitit 2020, 2021 dhe 2022.

#### 2.1.1 Kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të 2 nga 10 Qendrat e hapura me mbështetjen e UNDP.

Me hyrjen në fuqi të Urdhrit nr.382 të Ministrit të Drejtësisë, datë 08.06.2023 “Për kalimin si pjesë e strukturës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, të Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore Gjirokastër dhe Fier me nga një punonjës secila”, është miratuar kalimi nën administrim si pjesë e strukturës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Fier dhe Gjirokastër.

#### 2.1.2 Hapja e 6 qendrave të reja të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Me hyrjen në fuqi të Urdhrit nr.310, të Ministrit të Drejtësisë datë 02.05.2023 “Mbi hapjen dhe kalimin nën administrim të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të Qendrave të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Tropojë, Mat, Pukë, Kurbin, Kavajë dhe Përmet” është miratuar hapja si pjesë e strukturës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Tropojë, Mat, Pukë, Kurbin, Kavajë dhe Përmet, si rrjedhojë e riorganizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”.

#### **QSHNJP TROPOJË**

- Nënshkruar Marrëveshja nr.1374 prot, datë 29.06.2023 me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për sigurimin e ambienteve pa kundërshpërblim pranë ambienteve të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.
- Përfunduar procedura e përshtatjes së zyrës së vendosur në dispozicion nga Gjykata, dhe mobilimi.
- Hapur thirrja për aplikime për pozicionet: Punonjës me trajnim të posaçëm pranë Qendrës Tropojë (publikuar në faqen zyrtare të DNJF).
- Përfunduar procedura e rekrutimit të 1 (një) punonjëseje të Qendrës Tropojë.
- U mundësua realizimi i trajnimeve me temë “Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ku përmes këtij trajnimi punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, patën mundësinë të informohen mbi ofruesit e ndihmës juridike, kushtet për përftimin e ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese, procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas, procedurës së ndjekur në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike, mënyrës së raportimit etj.
- Janë ndjekur procedurat dhe është mundësuar pajisja me vula zyrtare si dhe hapja e email-eve zyrtare të Qendrave të reja.

#### **QSHNJP PËRMET**

- Nënshkruar Marrëveshja nr.1393 prot, datë 04.07.2023, me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për sigurimin e ambienteve pa kundërshpërblim pranë ambienteve të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

- Përfunduar procedura e përshtatjes së zyrës së vendosur në dispozicion nga Gjykata dhe mobilimi.
- Hapur thirrja për aplikime për pozicionet: Punonjës me trajnim të posaçëm pranë Qendrës Përmet (*publikuar në faqen zyrtare të DNJF*).
- Përfunduar procedura e rekrutimit të 1 (një) punonjëseje të Qendrës Përmet.
- U mundësua realizimi i trajnimeve me temë “*Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*”, ku përmes këtij trajnimi punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore patën mundësinë të informohen mbi ofruesit e ndihmës juridike, kushtet për përfitim të ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese, procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas, procedurës së ndjekur në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike, mënyrës së raportimit etj.
- Janë ndjekur procedurat dhe është mundësuar pajisja me vula zyrtare si dhe hapja e email-eve zyrtare të Qendrave të reja.

### ***QSHNJP MAT***

- Nënshkruar Marrëveshja nr.1326, datë 19.06.2023, me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për sigurimin e ambienteve pa kundërshtim pranë ambienteve të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.
- Përfunduar procedura e përshtatjes së zyrës së vendosur në dispozicion nga Gjykata dhe mobilimi.
- Hapur thirrja për aplikime për pozicionet: Punonjës me trajnim të posaçëm pranë Qendrës Mat (*publikuar në faqen zyrtare të DNJF*).
- Përfunduar procedura e rekrutimit të 1 (një) punonjëseje të Qendrës Mat.
- U mundësua realizimi i trajnimeve me temë “*Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*”, ku përmes këtij trajnimi punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore patën mundësinë të informohen mbi ofruesit e ndihmës juridike, kushtet për përfitim të ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese, procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas, procedurës së ndjekur në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike, mënyrës së raportimit etj.
- Janë ndjekur procedurat dhe është mundësuar pajisja me vula zyrtare si dhe hapja e email-eve zyrtare të Qendrave të reja.

### ***QSHNJP PUKË***

- Nënshkruar Marrëveshja nr.1298, datë 13.06.2023, me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për sigurimin e ambienteve pa kundërshtim pranë ambienteve të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.
- Përfunduar procedura e përshtatjes së zyrës së vendosur në dispozicion nga Gjykata dhe mobilimi.
- Hapur thirrja për aplikime për pozicionet: Punonjës me trajnim të posaçëm pranë Qendrës Pukë (*publikuar në faqen zyrtare të DNJF*).
- Përfunduar procedura e rekrutimit të 1 (një) punonjëseje të Qendrës Pukë.
- U mundësua realizimi i trajnimeve me temë “*Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*”, ku përmes këtij trajnimi punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore patën mundësinë të informohen mbi ofruesit e ndihmës juridike, kushtet për përfitim të ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese, procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas, procedurës së ndjekur në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike, mënyrës së raportimit etj.
- Janë ndjekur procedurat dhe është mundësuar pajisja me vula zyrtare si dhe hapja e email-eve zyrtare të Qendrave të reja.

### ***QSHNJP KURBIN***

- Nënshkruar Marrëveshja nr.1375 prot, datë 30.06.2023, me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për sigurimin e ambienteve pa kundërshpërblim pranë ambienteve të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.
- Përfunduar procedura e përshtatjes së zyrës së vendosur në dispozicion nga Gjykata dhe mobilimi.
- Hapur thirrja për aplikime për pozicionet: Punonjës me trajnim të posaçëm pranë Qendrës Kurbin (*publikuar në faqen zyrtare të DNJF*).
- Përfunduar procedura e rekrutimit të 1 (një) punonjëseje të Qendrës Kurbin.
- U mundësua realizimi i trajnimeve me temë “*Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*”, ku përmes këtij trajnimi punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore patën mundësinë të informohen mbi ofruesit e ndihmës juridike, kushtet për përfitim të ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese, procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas, procedurës së ndjekur në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike, mënyrës së raportimit etj.
- Janë ndjekur procedurat dhe është mundësuar pajisja me vula zyrtare si dhe hapja e email-eve zyrtare të Qendrave të reja.

### ***QSHNJP KAVAJË***

- Nënshkruar Marrëveshja nr.1362, datë 26.06.2023, me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për sigurimin e ambienteve pa kundërshpërblim pranë ambienteve të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.
- Përfunduar procedura e përshtatjes së zyrës së vendosur në dispozicion nga Gjykata dhe mobilimi.
- Hapur thirrja për aplikime për pozicionet: Punonjës me trajnim të posaçëm pranë Qendrës Kavajë (*publikuar në faqen zyrtare të DNJF*).
- Përfunduar procedura e rekrutimit të 1 (një) punonjëseje të Qendrës Kavajë.
- U mundësua realizimi i trajnimeve me temë “*Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*”, ku përmes këtij trajnimi punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore patën mundësinë të informohen mbi ofruesit e ndihmës juridike, kushtet për përfitim të ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese, procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas, procedurës së ndjekur në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike, mënyrës së raportimit etj.
- Janë ndjekur procedurat dhe është mundësuar pajisja me vula zyrtare si dhe hapja e email-eve zyrtare të Qendrave të reja.

**Me hapjen e këtyre 6 (gjashtë ) qendrave të reja u mundësua mbulimi me 20 (njëzet) Qendra të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.**

#### **2.1.3 Zhvendosja e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec.**

Nëpërmjet shkresës me nr.3060/1 prot, datë 02.08.2023, me lëndë: Kërkesë për bashkëpunim, të dërguar nga Bashkia Pogradec, Drejtorisë i është kërkuar kalimi në përdorim të Bashkisë Pogradec i ambienteve të cilat ishin në përdorim të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec.

Në vijim të kësaj shkrese, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, me shkresat me nr.1663 prot, datë 14.08.2023, i është drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, në drejtim të gjetjes së ambienteve, pa kundërshpërblim. Në drejtim të përshtetimit të procesit të zhvendosjes, përfaqësuesit e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas kanë zhvilluar vizita në institucionet vendore në qytetin e Pogradecit dhe Korçës.

U mundësua lidhja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me nr.1663/1 prot., datë 18.09.2023 dhe ***Qendra Pogradec ushtron veprimtarinë e saj pranë ambienteve të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec prej muajit Shtator 2023.***

#### 2.1.4 Zhvendosja e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë.

Prej Dhjetorit të vitit 2022, në mbështetje të marrëveshjes TIP të bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Bashkisë Korçë “*Për sigurimin e zyrës së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore pranë ambienteve të Bashkisë Korçë pa kundërshpërblim*”, nr.820/1 datë 23.03.2022, provizorisht në ambientet e Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, funksionoi QSHNJP Korçë, ku ushtroi detyrën një punonjëse me trajnim të posaçëm.

Në vijim, i është kërkuar Ministrisë së Drejtësisë konfirmim për zhvendosjen e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë në ambientet e ish -Gjykatës së Apelit Korçë dhe konfirmimin e investimeve që ka marrë përsipër të kryejë donatori UNDP, në këto ambiente.

Është vijuar me dërgimin e shkresës drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.1561/3, datë 30.08.2023 me lëndë: Njoftim për kryerjen e punimeve në ambientet e ish-Gjykatës së Apelit Korçë me qëllim transferimin në këto ambiente të Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë. Në vijim të kësaj shkrese, me shkresën nr.4578/2 datë 07.09.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor shpreh dakordësinë për vijimin e punimeve për përshtatjen e ambientit të ish Gjykatës së Apelit Korçë me qëllim transferimin e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë. ***Qendra Korçë ushtron veprimtarinë e saj pranë ambienteve të ish Gjykatës së Apelit Korçë, prej muajit Dhjetor 2023.***

## 2.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me qëllim ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, “*Klinikë ligjore*” është njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

Aktualisht DN

JF ka lidhur marrëveshje me 12 Institucione të Arsimit të Lartë dhe konkretisht:

1. Marrëveshje Bashkëpunimi me “*Universitetin Marin Barleti*”;
2. Marrëveshje Bashkëpunimi me “*Fakultetin e Drejtësisë*”;
3. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “*Bedër*”;

4. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “Wisdom”;
5. Marrëveshje Bashkëpunimi me “Universitetin European të Tiranës”;
6. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “Aleksandër Moisiu Durrës”;
7. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “Ismail Qemali Vlorë”;
8. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “Qiriazi”;
9. Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin OSFA (Klinika e Ligjit Shkodër);
10. Marrëveshje Bashkëpunimi me “Universitetin Mesdhetar”.
11. Marrëveshje Bashkëpunimi me “Universitetin Luarasi”.
12. Marrëveshja e Bashkëpunimit me nr.30 prot., datë 04.02.2022, me Universitetin “Epoka”.

Gjithashtu, referuar nenit 16 të ligjit Nr.111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, bashkëpunon me Klinikat e Ligjit, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.

Përgjatë vitit 2023, pas marrjes dijeni mbi nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit “Aleksandër Xhuvani” dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) në Shqipëri, mbi themelimin e Klinikës së Ligjit pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dërgoi shkresën me lëndë: Kërkesë për bashkëpunim, përmes së cilës shprehu interesin mbi mundësinë e bashkëpunimit, përmes nënshkrimit të një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin “Aleksandër Xhuvani”. Jemi në pritje të përgjigjes mbi shkresën e dërguar.

#### 2.2.1 Angazhimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në kuadër të zhvillimit të trajnimeve për studentët.

Është detyrim ligjor i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të bashkëpunojë me klinikat ligjore për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.

Për vitin 2023, janë trajnuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas **34** studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, të cilët u pajisën me Vërtetim për pjesëmarrjen në trajnimin me temë “Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit Nr.111/2017, “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”

Gjithashtu, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi trajnimet me temë “Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit Nr.111/2017, “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, me studentët e 12 (dymbëdhjetë) Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve me të cilat Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

Në këtë trajnim, studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, u informuan mbi ofruesit e ndihmës juridike, kushtet për përfitim të ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese si dhe procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas referuar moduleve të poshtëshënuara:

- Moduli nr. 1 “Ndhma juridike parësore”;
- Moduli nr. 2 “Ndhma juridike dytësore”;



- Moduli nr. 3 “Legjislacioni specifik për kategoritë e veçanta drejtëpërdrejtë përfituese të ligjit si dhe kategoritë me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme”;
- Moduli nr. 4 “Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane”.

Gjithashu u trajtuan raste praktike të lidhura ngushtësisht me problemet konkrete të institucioneve të administratës, kërkesat për informacion dhe ankesat, arritjet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmen.

### 2.2.2 Zhvillimi i praktikave 2 mujore të punës pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Tiranë, Durrës dhe Shkodër.

Për vitin 2023, kanë zhvilluar praktikat e punës pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë, Elbasan dhe Shkodër 34 studentë, të cilët u pajisën dhe me vërtetimet përkatëse.

### 2.3 Financimi nga Buxheti i Shtetit i Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë.

#### **Përfunduar procedura me dy organizata jofitimprurëse fituese.**

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ka ndërmarrë masat për publikimin në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të thirrjes për financimin e OJF-ve të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore (Afati i aplikimit 31.01.2023-01.03.2023):

Buletini nr. 6, viti 2023:

<https://qbz.gov.al/eli/bnjz/2023/6/95c6a821-3a21-4291-9c12-df4f471a4c24>

Gjithashtu, thirrja për financim gjendet e publikuar edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, në rubrikën njoftime, si vijon:

link: <https://drejtesia.gov.al/thirrjes-se-drejtorise-se-ndihmes-juridike-falas-per-financimin-e-organizatave-jofitimprures-te-autorizuara-per-ofrimin-e-ndihmes-juridike-paresore/>

1. Shkresa me nr.**270 prot., datë 30.01.2023**, drejtuar Ministrit të Drejtësisë, “Përcillen emrat e anëtarëve të DNJF për pjesëmarrje në KV dhe KA për shqyrtimin e aplikimeve për financim të organizatave”;
2. Shkresa me nr.**727/3 prot., datë 16.03.2023** e Ministrisë së Drejtësisë për përcjelljen e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.168, datë 13.02.2023 “Për ngritjen e komisionit vlerësues për shqyrtimin edhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara dhe të komisionit të ankimit për shqyrtimin e ankesave të organizatave jofitimprurëse të autorizuara”;
3. Shkresa me nr.**260 prot., datë 27.01.2022**, drejtuar QBZ, për dijëni Ministrisë së Drejtësisë “Kërkesë për publikimin e thirrjes për financimin e OJF-ve të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore”;

4. Shkresa me **nr. 260/1 prot., datë 27.01.2022**, drejtuar QBZ, për dijëni Ministrisë së Drejtësisë *“Kërkesë për publikimin e thirrjes për financimin e OJF-ve të autorizuarra për ofrimin e ndihmës juridike parësore”*.

Në bazë të nenit 15, të ligjit nr.111/2017 *“Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”*, VKM-së Nr.110, datë 6.3.2019, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuarra për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, Komisioni i Vlerësimit (ngritur me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.168, datë 13.02.2023), shqyrtoi aplikimet dhe verifikoi përmbushjen e kriterëve ligjore dhe financiare për secilën prej aplikimeve.

Pika 14, e vendimit nr. 110/2019, përcakton se: *“Komisioni vlerësues shqyrton aplikimet dhe vlerëson përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, si dhe cakton masën financiare përfituese brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e mbylljes së thirrjes publike.*

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas u administruan 3 (tre) ankesa ndaj Vendimit të Komisionit të Vlerësimit *“Për refuzimin e aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti”*.

Në bazë të pikës 17, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, *“Për përcaktimin e procedurave të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuarra për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, ankesat janë shqyrtuar nga Komisioni i Ankimit (ngritur me urdhrin nr.168, datë 13.02.2023, të Ministrit të Drejtësisë).

Referuar pikës 18, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.110, datë 06.03.2019, vendimi i arsyetuar i Komisionit të Ankimit i’u njoftua organizatave jofitimprurëse të autorizuar që bënë ankimin, jo më vonë se 2 (dy) ditë nga marrja e vendimit dhe u publikuan në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në linqet si vijon:

<https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/2023/03/31/per-shqyrtimin-e-ankimit-te-organizates-jofitimprures-qendra-per-mbrojtjen-e-te-drejtave-te-femijeve-ne-shqiperi-cra-ndaj-vendimit-te-komisionit-te-vleresimit-nr-9-dat/>

<https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/2023/03/31/per-shqyrtimin-e-ankimit-te-organizates-jofitimprures-she-bimi-ligjor-falas-tirane-tlas-ndaj-vendimit-te-komisionit-te-vleresimit-nr-7-date-13-03-2023-per-refuzimin-e-aplikimit-p/>

<https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/2023/03/31/per-shqyrtimin-e-ankimit-te-organizates-jofitimprures-qendra-e-gruas-hapa-te-lehte-ndaj-vendimit-te-komisionit-te-vleresimit-nr-5-date-13-03-2023-per-refuzimin-e-aplikim/>

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas në bazë të Ligjit Nr. 111/2017 *“Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”* dhe VKM-së Nr. 110, datë 06.03.2019 *“Për përcaktimin e procedurave dhe*

të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF Nr.37, datë 06.04.2021, “Për miratimin e dokumentave tip të aplikimit nga organizat jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit”, përfundoi me sukses procedurën e financimit të 2 organizatave jofitimprurëse të cilat tashmë do të ofrojnë shërbime ligjore të financuara nga buxheti i shtetit.

Pas një procedure konkurruese u shpallën fituese dy prej tyre, organizata “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza” dhe “Qendra Psiko-Sociale Vatra”.

Nënshkruar kontrata me nr.563/4 prot., datë 27.03.2023 me organizatën “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”.

Nënshkruar kontrata me nr.559/4 prot., datë 27.03.2023 me organizatën “Qendra Psiko-Sociale Vatra”.

Përcjellë raporti Prill-Qershor i organizatës jofitimprurëse të autorizuar “Linja e këshillimit për gra dhe vajza” dhe organizatës “Qendra Psiko-Sociale Vatra”.

Përcjellë raporti Korrik-Shtator i organizatës jofitimprurëse të autorizuar “Linja e këshillimit për gra dhe vajza” dhe organizatës “Qendra Psiko-Sociale Vatra”.

#### 2.4 Të dhënat statistikore për vitin 2023, ndihma juridike parësore.

**47 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike të cilët gjejnë shtrirje në 100 % të territorit të vendit:**

- ✓ **20 (njëzet) Qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore** në Tiranë, Lushnjë, Durrës, Shkodër, Fier, Gjirokastrë, Tropojë, Përmet, Puka, Mati, Kavajë, Kurbin, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Dibër, Kukës, Korçë, Berat, Elbasan.
- ✓ **15 (pesëmbëdhjetë) Organizata jofitimprurëse** të cilat operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Berat; Shkodër dhe Vlorë të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë
- ✓ **12 (dymbëdhjetë) marrëveshje bashkëpunimi me klinikat ligjore** pranë IAL-ve që operojnë në Tiranë; Durrës; Vlorë dhe Shkodër.
- ✓ *Ndihma Juridike Parësore ONLINE (platformajuristionline.al).*
- ✓ *Numri i gjelbër pa pagesë 08001010.*

**Numri total i rasteve të raportuara, nga të gjithë ofruerit e shërbimit të ndihmës juridike parësore: 20 Qendra të Shërbimit, 15 OJF dhe 12 Klinika të Ligjit, për periudhën Janar – Dhjetor 2023 është 7008 raste të raportuara<sup>1</sup>.**


<sup>1</sup> Rastet e trajtuara në total, së bashku me Platformën Juristi Online dhe Nr. i Gjelbër, për periudhën Janar – Dhjetor 2023 është **7946**

Rastet e trajtuara nga Platforma Juristi Online për periudhën Janar – Dhjetor 2023 është **766**.

Rastet e trajtuara nga Numri i Gjelbër për periudhën Janar – Dhjetor 2023 është **172**.

- Rastet e raportuara nga ofruesit e shërbimit për muajt Janar – Dhjetor 2023, paraqiten në mënyrë tabelare dhe grafike, si vijon:


Muaji	Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	Organizatrat Jofitimprurëse të autorizuara	Klinikat e Ligjit pranë IAL	Total
Janar	305	281	0	<b>586</b>
Shkurt	295	251	0	<b>546</b>
Mars	324	177	14	<b>515</b>
Prill	283	265	1	<b>549</b>
Maj	321	212	3	<b>536</b>
Qershor	326	223	0	<b>549</b>
Korrik	312	234	0	<b>546</b>
Gusht	296	166	0	<b>462</b>
Shtator	384	332	2	<b>718</b>
Tetor	481	248	0	<b>729</b>
Nëntor	438	247	0	<b>685</b>
Dhjetor	329	255	3	<b>587</b>
<b>Total</b>	<b>4094</b>	<b>2891</b>	<b>23</b>	<b>7008</b>



Të dhëna statistikore të ndihmës juridike parësore, të kategorizuara sipas:


- Gjinisë:

Lloji i ndihmës	Meshkuj	Femra	E Papërcaktuar	Nr. Total i rasteve për të gjithë qytetarët përfitues - 2023
<i>Nr raste nga të gjithë ofruesit e ndihmës juridike parësore</i>	2589	4389	30	<b>7008</b>
<i>Përqindje</i>	37%	63%	0%	




- Sipas natyrës së çështjes:

Lloji i ndihmës	Civile	Penale	Administrative	E Papërcaktuar	Nr. Total i rasteve për të gjithë qytetarët përfitues - 2023
<i>Nr raste nga të gjithë ofruesit e ndihmës juridike parësore</i>	2730	355	3572	234	<b>7008</b>
<i>Përqindje</i>	40%	5%	52%	3%	



- **Sipas Kategorive përfituese të përcaktuara në ligj:**

Lloji i ndihmës	Kategoritë pa të ardhura dhe pasuri	Kategoritë e veçanta	E papërcaktuar	Nr. Total i rasteve për të gjithë qytetarët përfitues - 2023
<i>Nr raste nga të gjithë ofruesit e ndihmës juridike parësore</i>	3673	2892	443	<b>7008</b>
<i>Përqindje</i>	53%	41%	6%	



Neni 11, i Ligjit nr.111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” parashikon në mënyrë shteruese 12 kategori të veçanta, përfitues të ndihmës juridike falas, pavarësisht të ardhurave dhe pasurive që disponojnë.

**Për vitin 2023, vihet re se kategoritë me numër me të madh përfituesish, vetëm për ndihmën juridike parësore, janë:**

1. Viktima të dhunës në familje – 1131 përfitues
2. Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale – 767 përfitues  
Pensionistë – 112 përfitues
3. Statusi i të verbrit – 115 përfitues
4. Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar/ KMCAP – 527 përfitues
5. Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore – 92 përfitues
6. Përfitues të ndihmës ekonomike – 89 përfitues
7. Viktima të mitur – 21 përfitues
8. Viktima të abuzuar seksualisht – 12 përfitues

2.4.1 Kategoritë e veçanta të përcaktuara në Ligj, përfitues të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, viti 2023.

Kategoria e veçantë	Ndihmë Juridike Parësore	Ndihmë Juridike Dytësore	Kategoria Total
Viktima të dhunës në familje	1131	112	1243
Viktima të abuzuar seksualisht	12		12
Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	92	1	93
<b>Viktima të mitur<sup>2</sup></b>	<b>21</b>		<b>21</b>
Të mitur në konflikt me ligjin	2		2
Fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore	0	2	2
Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor	0	1	1
Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar/ KMCAP	527	102	629
Statusi i të verbrit	115	29	144
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm dhe vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor dhe	0		
Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar	3		3
Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	767	119	886
Përfitues të ndihmës ekonomike	89		89
Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor	0		
Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim	1		1
Pensionistë	112	25	137
E papërcaktuar kategoria e veçantë përfituese	116	1	117
<b>Nr. Total i kategorive të veçanta - Ndihmë Juridike Parësore &amp; Dytësore - 2023</b>	<b>2867</b>	<b>392</b>	<b>3259</b>
Romë/egjiptiane	411	-	411
Të mitur total <sup>3</sup>	399	-	399

<sup>2</sup> Viktimat e mitur, nuk përllogariten në **Nr. Total i përfituesve sipas kategorisë së veçantë Ndihmë Juridike Parësore & Dytësore – 2023**, pasi janë përllogaritur si viktima dhune, abuzimi seksual apo viktima trafikimi.

<sup>3</sup> Të mitur total nuk përfshin përllogaritjen e nr e viktimave të mitur, apo të mitur në konflikt me ligjin, si kategori e veçantë.

### 3. Ndhimja juridike dytësore

Ndhimja juridike dytësore është një nga format më thelbësore të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në kuadër të garantimit të aksesit të barabartë në drejtësi. Referuar kuadrit ligjor për ndihmën juridike, përveç përfaqësimit me avokat falas, tashmë qytetarët në nevojë dhe kategoritë vulnerabël kanë mundësi të përfitojnë edhe përjashtimin nga të gjitha tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Nisur dhe nga natyra e çështjeve të ndihmës juridike, karakteri sensitiv që ato kanë, përfaqësimi me avokat falas dhe ndjekja e procesit në gjykatë është i një rëndësie thelbësore për rivendosjen në vend të të drejtave për kërkuesit e shërbimit.

Ndhimja juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, Ligjit Nr.111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”.

#### 3.1 Proçesi i lidhjes së kontratave me avokatët

Në zbatim të kompetencave të përcaktuara në nenin 8, të ligjit nr. 111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”, gërma k), Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

Në muajin Janar, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit për përgatitjen e listës dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proçeset civile dhe administrative për vitin 2023.

Gjatë kësaj procedure u respektua “Parimi i Rotacionit”, si dhe të gjitha rregullat e parashikuara në Udhëzimin e Përbashkët Nr.17, datë 05.08.2020, të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, duke garantuar kështu një proçes transparent dhe gjithëpërfshirës.

Pas miratimit të listës së avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas vijoi me proçesin e lidhjes së kontratave me avokatët e miratuar nga DHASH, për vitin 2023.

Janë lidhur kontratat me avokatët për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dhe Lista e Avokatëve është publikuar në faqen zyrtare të DNJF. Nga **160 avokatë** që lidhën kontratë për ofrimin e shërbimit për ndihmën juridike dytësore, **1** avokat u tërhoq në mënyrë të njëanshme. Lista i është komunikuar Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe Ministrisë së Drejtësisë me shkresën Nr.617 prot., datë 07.03.2023. Në vijim, gjatë vitit 2023 kanë ofruar shërbimin e ndihmës juridike dytësore **159 avokatë**.



### 3.2 Trajnimi i avokatëve pjesë e listës.

Me qëllim asistimin e avokatëve në procesin e dhënies së ndihmës juridike dytësore, raportimit për sa i përket ndjekjes së çështjeve; ndërveprimin të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me Dhomat Vendore të Avokatisë, si dhe të shkëmbimit të konsideratave janë zhvilluar trajnime dedikuar për ndihmën juridike dytësore.

Referuar nenit 9, shkronjës “d”, të ligjit nr.111/2017 “*Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti*” parashikon se: Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

Në zbatim të detyrave ligjore DHASH, në bashkëpunim me DNJF kanë organizuar trajnimet e mëposhtme:

- Më datë 21 Nëntor 2023, është zhvilluar trajnimi për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore me temë “*Trajnimi i trajnerëve*”.
- Zhvilluar trajnimi për avokatët ofrues të ndihmës juridike dytësore të Dhomës Avokatisë Durrës dhe Lushnjë, të përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë trajnim mbi legjislacionin e ndihmës juridike dhe problemet që lidhen me zbatimin e tij.

Gjatë trajnimeve, ofruesve të ndihmës juridike dytësore ju është vënë theksi specifikisht si më poshtë:

- Ligji për ndihmën juridike dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij;
- Format e shërbimit të ndihmës juridike dhe subjektet përfitues të shërbimit;
- Legjislacioni mbi ndihmën juridike dhe rëndësia e tij edhe në nivel ndërkombëtar;
- Analizë në aspektin praktik;
- Standardet e ofrimit të shërbimit në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së;
- Diskutime praktike ndërmjet ofruesve të shërbimit, Dhomave të Avokatisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Pas diskutimeve të temave mbi kuadrin ligjor të përgjithshëm mbi ndihmën juridike, aspektet e dala nga zbatimi në praktikë i ligjit, trajnimet ju dedikuan dhe temave të posaçme të lidhura me kategoritë e veçanta përfituese të ligjit.

### 3.3 Ecuria e vendime për pranimin e ndihmës dytësore.

Nga vendimet gjyqësore me objekt kërkesën për ndihmë juridike dytësore falas, të administruara nga DNJF për Vitin 2023, në total rezultojnë **773** vendime gjyqësore. Këto vendime mbi kërkesat për ndihmë juridike dytësore të detajuara në formë tabelare janë si vijon:


## Vendime Gjyqësore me Objekt Kërkesën për Ndihmë Juridike Dytësore

### JANAR – DHJETOR 2023

Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore	Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore	Pranim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Rrëzim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Kthim aktesh/pushim cështjeje/cështje në gjykim/moskompetencë
<b>119</b>	<b>3</b>	<b>74</b>	<b>3</b>	<b>536</b>	<b>25</b>	<b>13</b>

**Totali i Vendimeve Gjyqësore për Kërkesat për Ndihmë Juridike Dytësore = 773**

### Numri i vendimeve gjyqësore për çdo muaj 2023





Në ecurinë përgjatë muajve, mesatarja aritmetike e kërkesave të pranura për ndihmë dytësore juridike është përafërsisht **64** kërkesa për muaj. Muaji me numrin më lartë të kërkesave të pranura ishte muaji **Maj** me **86** vendime dhe numri me numrin më të ulët të kërkesave të pranura ishte muaji **Gusht** me **17** vendime.


**Të dhëna statistikore të ndihmës juridike dytësore, të paraqitura në mënyrë grafike sipas:**

**- Kategorisë përfituese**

**- Gjinisë**



Përsa i përket kategorive të personave kërkues të ndihmës juridike dytësore falas, në total evidentohet se **43%** e përfituesve janë në pamundësi financiare, si mungesë të ardhurash dhe pasurie, në **44%** përfshihen kategoritë e veçanta ligjore si personat viktimë të dhunës, përfitues të skemave sociale e të tjerë, ndërsa **13%** e tyre janë kategori e papërcaktuar. Përsa i përket gjinisë, **71%** e kërkuesve rezultojnë gra dhe **29%** rezultojnë burra.




Sipas objektit të çështjeve gjyqësore që qytetarët kanë kërkuar ndihmë juridike dytësore, evidentohet që kryesisht që janë çështje të karakterit civil. Nga totali i kërkesave për ndihmë juridike prej **773**, prej tyre **647** janë civile, ku më kryesoret janë zgjidhje martese, përfitim pensioni dhe konflikte pronësie. Ndërsa kategoritë e tjera **50** janë penale, **71** janë çështje administrative dhe në **5** vendime nuk evidentohet lloji i çështjes .

Përsa i përket pranimit të kërkesave të qytetarëve nga vendimet e gjykatave, evidentohet një marzh shumë i ulët i refuzimit. Nga totali i kërkesave, në **31** vendime gjykatat janë shprehur për refuzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore falas, thënë ndryshe në **4%** të totalit.

Referuar detyrimeve dhe tagrave ligjore, Drejtoria Ndhmës juridike Falas përsa i përket vendimeve për pranim të dhëna nga gjykatat, ka kryer ankime dhe ankesa për ndreqje gabimesh. Përsa i përket ankimeve, DNJF ka ankimuar ose ka bërë kërkesë për ndreqje gabimi për rreth **5%** të totalit. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre kërkesave kanë ardhur për mangësi formale në vendimmarrjen e gjykatave, por edhe një pjesë zënë raste ku DNJF ka pretenduar një vendimmarrje jo të saktë nga gjykatat. Konkretisht, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka ushtruar të drejtën e ankimit për **34** raste.

Përsa i përket llojit të ndihmës juridike dytësore falas të kërkuar, nga **773** vendime në total, **124** prej tyre janë për kërkesa për të përfituar avokat, **79** për të përfituar mbulim të shpenzimeve gjyqësore dhe **570** janë kërkesa për për të përfituar avokat dhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore, nga të cilat janë rrëzuar **31** kërkesa dhe **13** janë kthim aktesh/pushim çështje.



### 3.4 Caktimi i Avokatëve

Nëse analizojmë vendimmarrjen e gjykatave, të përshkruar më sipër, konkretisht, rezulton se Dhomat Vendore të Avokatisë do të duhej të kishin komunikuar vendimmarrjen për caktim të **635 avokatëve**. Ky numër rezulton nga totali i kërkesave për të përfituar avokat dhe kërkesave për të përfituar avokat dhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore. Prej këtij totali, zbritet numri i vendimeve të marra për refuzim të kërkesës nga gjykatat<sup>4</sup>.

Nga analiza e të dhënave rezulton se, Dhoma Vendore e Avokatisë Durrës ka përcjellë numrin më të lartë të vendimeve për caktimin e avokatëve për **88** raste. Ajo ndiqet nga Dhoma Vendore Gjirokastrë për **31** raste dhe Dhoma Vendore Vlorë për **28** raste. Në total rezulton se nga Dhomat Vendore janë përcjellë **181** vendime për caktim avokatësh, të cilat i janë komunikuar DNJF përgjatë vitit 2023.


Përcjellja e vendimeve për caktim avokati për vitin 2023		
Nr.	Dhoma Vendore të Avokatisë	Nr. i vendimeve
1	Dhoma vendore e Avokatisë Durrës	88
2	Dhoma vendore e Avokatisë Berat	20
3	Dhoma vendore e Avokatisë Lezhë	5
4	Dhoma vendore e Avokatisë Gjirokastrë	31
5	Dhoma vendore e Avokatisë Dibër	6
6	Dhoma vendore e Avokatisë Vlorë	28
7	Dhoma vendore e Avokatisë Elbasan	1
8	Dhoma vendore e Avokatisë Sarandë	2

Sipas këtyre shifrave, rezulton se për rreth **2/3 të vendimeve gjyqësore** që kanë pranuar kërkesën e qytetarëve për avokatë, Dhomat Vendore të Avokatisë nuk kanë komunikuar vendimin e caktimit të avokatit. Në këto rrethana, ndër të tjera, bëhet e pamundur vlerësimi nëse Dhomat kanë respektuar parimin e rotacionit në vendimmarrjen e tyre.

<sup>4</sup> Nga ky numër duhet të zbritet, në rastin nëse gjykatat do të pranojnë ankimet e depozituara nga DNJF.

### 3.5 Një konkluzion i të dhënave statistikore me një qasje krahasuese

- I. Nga analiza e të dhënave, në ecurinë përgjatë viteve 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 konstatohet ky numër kërkesash për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Më konkretisht, për vitin 2019, janë marrë **32** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike, në vitin 2020, janë marrë **181** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike, për vitin 2021 janë **849** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike të garantuar nga shteti, për vitin 2022 janë **1030** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike të garantuar nga shteti, ndërsa për vitin 2023 janë marrë **773** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike dytësore.
- II. Me implementimin e hartës së re gjyqësore ku u shkrinë 9 (nëntë) gjykatat e rretheve gjyqësore si: Tropojë, Mat, Kurbin, Pukë, Krujë, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Pogradec solli për vitin 2023 uljen e numrit të vendimeve për ndihmë juridike dytësore. Theksojmë që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka hapur në disa qytete Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore me qëllim garantimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve.
- III. Përsa i përket raportit të natyrës së çështjeve gjyqësore për të cilat është kërkuar ndihmë, në analizë disa vjeçare shihet ruajtja e plotë e raportit. Më konkretisht çështjet civile shkojnë deri më 90% të totalit të çështjeve për të cilat kërkohet ndihmë. Më konkretisht, në vitin 2019, nga 32 vendime, 28 ishin për çështje civile, 4 penale dhe 1 administrative. Në vitin 2020, nga 181 vendime, 154 ishin për çështje civile, 13 penale dhe 14 administrative, për vitin 2021 nga 849 vendime, 754 ishin për çështje civile, 61 penale dhe 57 administrative, ndërsa për vitin 2022 nga 1030 vendime, 691 ishin për çështje civile, 70 penale dhe 269 administrative, ndërsa për vitin 2023 nga 773 vendime ishin 647 për çështje civile, 50 penale dhe 73 administrative dhe 5 vendime të papërcaktuara llojin e çështjes.



**TOTAL NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE 2019-2023 = 2.877 VENDIME GJYQËSORE**

### 3.6 Problematika lidhur me ndihmën juridike dytësore

1. Është vënë re se avokatët kalojnë afatin 3 mujor për depozitimin e padisë së përfituesve së ndihmës juridike dytësore në gjykatat kompetente;
2. Dhomat Vendore të Avokatisë nuk përcjellin vendimet për caktim avokati pranë DNJF-së;
3. Disa vendime të gjykatave me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore vijnë pa firmë dhe vulë, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, përmendim këtu Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë etj;
4. Vendimet e Gjykatave me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore administrohen me vonesë në DNJF;
5. Vendimet e marra nga gjykatat nuk shprehen në dispozitiv për aq sa i kërkohen në objekt, pasi ligji nr. 111/2017 *“Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”*, ka parashikuar dy forma të ndihmës juridike dytësore: Kërkesë për ndihmë juridike dytësore (avokat), si dhe kërkesë për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore ku përfshihen ekspertët, etj.
6. Problematikë qëndron dhe me tarifat e parashikuara në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 12.12.2012 *“Për pagesat e ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”*, i ndryshuar. Në këtë udhëzim përcaktohet qartë se vlera nuk duhet të kalojë shumën 40.000 lekë, edhe për pagesat që drejtoria bën në lidhje me ADN-të. DNJF me shkresën e saj nr.1466 prot., datë 11.07.2023 i ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë propozim ligjor për një shtesë në Udhëzimin nr.4, datë 12.12.2012 *“Për pagesat e ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”*. Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 4497/3 prot., datë 10.11.2023, protokolluar me tonën nr.1466/1 prot., datë 14.11.2023 me objekt *“Mbi propozimet për ndryshime në disa akte nënligjore”*, është shprehur për mospranimin e propozimit.

## 4. Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore dhe dytësore

### 4.1 Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore (Janar-Dhjetor 2023).

Referuar ligjit nr.111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, në nenin 8 të tij, përcaktohet si një ndër detyrat e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas: Zbatimi i sistemit të vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike dhe mbikëqyrja çdo vit e standardeve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët.

Në zbatim të këtyre parashikimeve, me Urdhrin nr.534, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”, është miratuar metodologjia që do të ndiqet për të vlerësuar dhe mbikëqyrur cilësinë e shërbimeve të ofruara të ndihmës juridike.

Për të përmbushur qëllimet e përaaktuara në ligj, Sektori i Monitorimit të Ofruesve të Ndhmës Juridike Parësore dhe Dytësore në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Standardeve dhe Administrimit të Ndhmës Dytësore, pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas që ka përgjegjësinë e kryerjes së monitorimeve fillestare dhe të vazhdueshme në funksion të vlerësimit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Krijimi i një sistemi të ndihmës juridike falas i cili siguron akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë, mirëorganizimi, mirëadministrimi dhe mirëfunksionimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike si dhe garantimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive janë disa nga qëllimet kryesore të ligjit nr.111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”.

Këto qëllime shërbejnë si udhëzues të mënyrës si kryhet monitorimi i cilësisë së shërbimit, proces i cili detajohet në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.531, datë 25.11.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Në përmbushje të nenit 8, pika 2, shkronja “ll”, e ligjit nr.111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti” përcaktohet se: “Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore”, DNJF ka hartuar kalendarin e mbikëqyrjes për vitin 2023, në të cilin ka detajuar të gjitha monitorimet që do të kryhen përgjatë këtij viti.

Lidhur me monitorimin e avokatëve të ndihmës juridike, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve dhe Administrimit të Ndhmës Dytësore ka vijuar me monitorimin fillestar dhe të vazhdueshëm të avokatëve ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.



#### 4.1.1 Analizë e raporteve të monitorimit të kryera në Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.

Referuar parashikimeve të metodologjisë së miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.591/2019, vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Qendrat bazohet në monitorimet 3 (tre)- mujore të kryera, si dhe në raportet mujore narrative të përcjella nga ana e punonjësve të Qendrave. Për çdo raport mujor të përcjellë analizohen të dhënat, orientimi ligjor, si dhe zgjidhja e rasteve të trajtuara. Gjithashtu, raportet synojnë të adresojnë problematika dhe rekomandime nga ana e punonjësve të qendrave, në funksion të përmirësimit të ecurisë së veprimtarisë dhe ofrimit të shërbimit nga ana e tyre.

#### **Nga monitorimet e kryera në Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, ka rezultuar se:**

- *Lidhur me mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit nr.111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”:*

Pjesa më e madhe e Qendrave administrojnë dokumentacionin që kërkohet për të përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike parësore (*formularët e aplikimit; dokumentat vërtetues për kushtet e pamundësisë/kategoritë e veçanta; skeda e klientit; procesverbali etj*), por jo të gjitha Qendrat administrojnë dokumentacion plotë (*mbajtjen e formularëve, dokumentacionin provues -shkresor ose në çdo formë tjetër të kërkuar nga ligji*).

- *Pritja dhe trajtimi i qytetarëve, përfitues të shërbimit:*

Pritja dhe trajtimi i klientëve duhet të formalizohet përmes një protokollit të mirëfilltë, sipas parashikimeve në Urdhrin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë (*ky protokoll mund të punohet duke bashkëpunuar edhe me punonjësit e Qendrave*). Rezulton se pjesa më e madhe e Qendrave nuk e kanë këtë dokument.

- *Rregullorja e Proçesit të Punës*

Për të mundësuar që proçesi i punës të rrjedhë rregullisht, Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore duhet të veprojnë bazuar në Rregulloren e proçesit të punës, ku të përcaktohen detyrat e stafit, rregullat kryesore të proçesit të punës. Nga monitorimet e kryera rezulton se, disa Qendra nuk disponojnë rregullore të proçesit të punës me përcaktime të qarta të të gjitha kompetencave dhe proçeseve mbikqyrëse e miratuar dhe e njohur nga punonjësit.

#### **Rekomandime:**

- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me efikasitet të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.
- Në fokus: rritja e numrit të rasteve që adresohen pranë qendrës.
- Rekomandohet bashkëpunimi edhe me qendrat e reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore të administruara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

#### 4.1.2 Ecuria e kryerjes së monitorimeve të qendrave.

Monitorimet u ushtruan duke pasur në fokus, mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunksionimit, profesionalizmit, cilësisë dhe efektivitetit.

- Monitorimi dhe kontaktimi i vazhdueshëm me qendrat është një proces periodik që është realizuar sipas kalendarit të monitorimeve për vitin 2023.
- Pas miratimit të Kalendarit të Monitorimeve për vitin 2023, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr.14, datë 17.01.2023, protokolluar me nr.145 Prot., datë 17.01.2023 janë kryer Monitorimet për Qendrat e Ndihmës Juridike Parësore.
- Monitorimi i QSHNJP Shkodër realizuar sipas urdhrit nr.3, datë 06.01.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër”*;
- Monitorimi i QSHNJP Korçë realizuar sipas urdhrit nr.9, datë 11.01.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë”*;
- Monitorimi i QSHNJP Gjirokastrë realizuar sipas urdhrit nr.253, datë 23.05.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë”*;
- Monitorimi i QSHNJP Vlorë realizuar sipas urdhërit nr.207, datë 25.04.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë”*;
- Monitorimi i QSHNJP Durrës realizuar sipas urdhërit nr.164, datë 05.04.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Durrës”*;
- Monitorimi i QSHNJP Lushnjë realizuar sipas urdhërit nr.54, datë 15.02.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lushnje”*;
- Monitorimi i QSHNJP Tiranë realizuar sipas urdhërit nr.116, datë 13.03.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë”*;
- Monitorimi i QSHNJP Berat realizuar sipas urdhërit nr.55, datë 15.02.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Berat”*;
- Monitorimi i QSHNJP Lezhë realizuar sipas urdhrit nr.222, datë 05.05.2022 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë”*;
- Monitorimi i QSHNJP Fier realizuar sipas urdhrit nr.205, datë 25.04.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier”*;
- Monitorimi i QSHNJP Pogradec realizuar sipas urdhrit nr.10, datë 11.01.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec”*;
- Monitorimi i QSHNJP Elbasan realizuar sipas urdhrit nr.251, datë 23.05.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan”*;
- Monitorimi i QSHNJP Dibër realizuar sipas urdhrit nr.280, datë 07.06.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Dibër”*;
- Monitorimi i QSHNJP Përmet realizuar sipas urdhrit nr.447, datë 29.09.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Përmet”*;
- Monitorimi i QSHNJP Kurbin realizuar sipas urdhrit nr.449, datë 29.09.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kurbin”*;
- Monitorimi i QSHNJP Pukë realizuar sipas urdhrit nr.446, datë 29.09.2023 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pukë”*;

- Monitorimi i QSHNJP Kavajë realizuar sipas urdhrorit nr.435, datë 25.09.2023 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Kavajë”;
- Monitorimi i QSHNJP Tropojë realizuar sipas urdhrorit nr.445, datë 29.09.2023 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tropojë”;
- Monitorimi i QSHNJP Mat realizuar sipas urdhrorit nr.448, datë 29.09.2023 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Mat”;
- Monitorimi i QSHNJP Gjirokastrë realizuar sipas urdhrorit nr.510, datë 03.11.2023 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastrë”;
- Monitorimi i QSHNJP Vlorë realizuar sipas urdhrorit nr.517, datë 14.11.2023 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë”;
- Monitorimi i QSHNJP Pogradec realizuar sipas urdhrorit nr.543, datë 12.12.2023 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec”;
- Monitorimi i QSHNJP Korçë realizuar sipas urdhrorit nr.468, datë 09.10.2023 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë”;
- Monitorimi i QSHNJP Berat realizuar sipas urdhrorit nr.456, datë 02.10.2023 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Berat”;
- Monitorimi i QSHNJP Lushnjë realizuar sipas urdhrorit nr.457, datë 02.10.2023 “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnje”.

<b>Kalendari i monitorimeve të kryera për vitin 2023</b>		
<b>Nr.</b>	<b>Qendrat e Shërbimit</b>	<b>Kryerja e Monitorimit</b>
<b>1</b>	Qendra Durrës	06.04.2023
<b>2</b>	Qendra Tiranë	15.03.2023
<b>3</b>	Qendra Lushnje	16.02.2023-17.02.2023; 03.10.2023
<b>4</b>	Qendra Berat	16.02.2023-17.02.2023; 02.10.2023-03.10.2023
<b>5</b>	Qendra Lezhë	08.05.2023-09.03.2023
<b>6</b>	Qendra Pogradec	24.01.2023-25.01.2023; 13.12.2023
<b>7</b>	Qendra Fier	27.04.2023-28.04.2023
<b>8</b>	Qendra Elbasan	31.05.2023
<b>9</b>	Qendra Dibër	29.05.2023-30.05.2023
<b>10</b>	Qendra Shkodër	30.01.2023-31.01.2023
<b>11</b>	Qendra Vlorë	27.04.2023-28.04.2023; 15.11.2023-16.11.2023

12	Qendra Gjirokastrër	29.05.2023-30.05.2023; 06.11.2023-07.11.2023
13	Qendra Kavajë	26.09.2023
14	Qendra Kurbin	23.10.2023
15	Qendra Pukë	24.10.2023-25.10.2023
16	Qendra Tropojë	10.10.2023-11.10.2023
17	Qendra Përmet	26.10.2023-27.10.2023
18	Qendra Mat	25.10.2023
19	Qendra Kukës	30.01.2023-31.01.2023
20	Qendra Korçë	24.01.2023-25.01.2023;14.12.2023

#### 4.1.3 Konkluzione dhe Rekomandime nga Monitorimet e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.

Nga monitorimi i kryer pranë Qendrave të Ndhmës Juridike Parësore rezulton se:

- Është mbajtur numri i rasteve të trajtuara për periudhën Janar- Dhjetor 2023 (*raste të raportuara sipas Formateve të miratuara në Ministrinë e Drejtësisë*).
- Është mbajtur skeda e klientit pjesërisht për ndihmën juridike parësore (*Aneksi 1, detyrim ligjor që rrjedh nga Urdhër nr.531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për Miratim e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës*).
- Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmë juridike parësore, pjesërisht sikurse është përcaktuar në ligj. (*Nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se punonjësit kanë mbajtur dhe plotësuar në mënyrë të rregullt dhe administrojnë formularët e ndihmës juridike parësore sikurse parashikohet në ligj dhe aktet nënligjore*).
- Është mbajtur dhe administrohet dokumentacioni provues pjesërisht që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar. (*Nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se nga ana e punonjësve të qendrës administrohet dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës dhe që është subjekt përfitues nga ndihma juridike falas*);
- Rezulton që në disa qendra nuk ka një protokoll të formalizuar për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.

#### **Rekomandime:**

- Të ofrohet shërbimi i ndihmës juridike parësore me cilësi dhe eficiencë të plotë duke trajtuar çdo rast sipas formateve të miratuara me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

- Të unifikohet një protokoll i formalizuar për procesin e pritjes dhe trajtimit të qytetarit sipas metodologjisë së miratuar me Urdhër ministri.
- Të mbahet gjithmonë dokumentacioni i plotë provues për përfituesit e ndihmës juridike parësore dhe ndihmës juridike dytësore sipas përcaktimeve në ligjin nr.111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti” dhe akteve nënligjore në funksion të tij;
- Të synohet rritja e numrit të rasteve që adresohen pranë qendrave.

Nga monitorimet e kryera gjatë viti 2023 vërehet se, ndihma juridike parësore ka konsistuar në rastet më të shumta në dhënien e ndihmës për të kërkuar ndihmë juridike parësore, më pas në rastet e dhënies së këshillimit dhe informimit në lidhje me aktet normative në fuqi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave. Ndhma Juridike Parësore nga Qendrat përveç shërbimeve të mësipërme, ka evidentuar dhe dhënien e ndihmës juridike të hartimit dhe përpilimit të dokumenteve të nevojshme drejtuar organeve shtetërore, por ky shërbim duhet të vijojë përfshirë dhe përfaqësimin përpara organeve administrative, deri në zgjidhjen e rasteve të paraqitura nga qytetarët pranë QSHNJP.

#### 4.2 Monitorimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

Sipas hartimit dhe miratimit të Kalendarit të Monitorimeve për vitin 2023 me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr.14, datë 17.01.2023, protokolluar me 145 prot., datë 17.01.2023;

Monitorimi i avokatëve është kryer nëpërmjet përcjelljes së dokumentacionit nga ana e avokatëve sipas kriterëve të vlerësimit, të metodologjisë dhe procedurave të mbikëqyrjes. Ky proces ka vijuar, në zbatim të Urdhërit nr.531, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”,

Në vijim të vlerësimit dhe mbikëqyrjes së ofrimit të shërbimit nga avokatët është realizuar monitorimi i avokatëve të DHVA dhe janë hartuar Memot lidhur me vlerësimin e të gjitha IKV-ve, si më poshtë vijon:

- Monitorimi për avokatët e DHVA Tiranë, referuar Memos me nr.1609/1 Prot., datë 15.08.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Durrës, referuar Memos me nr.815/2 Prot., datë 11.04.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Fier, referuar Memos me nr.928 Prot., datë 04.05.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Lushnje, referuar Memos me nr.1862/2 Prot., datë 05.10.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Dibër, referuar Memos me nr.1256/1 Prot., datë 19.06.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Shkodër, referuar Memos me nr.1015/2Prot., datë 11.05.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Berat, referuar Memos me nr.1859/2Prot., datë 05.10.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Pogradec, referuar Memos me nr.2299/1 Prot., datë 19.12.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Korçë, referuar Memos me nr.1860/2 Prot., datë 19.12.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Elbasan, referuar Memos me nr.1137/2 Prot., datë 02.06.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Vlorë, referuar Memos me nr.930/2 Prot., datë 04.05.2023.

- Monitorimi për avokatët e DHVA Gjirokastrë, referuar Memos me nr.1139/2 Prot., datë 02.06.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Lezhë, referuar Memos me nr.1013/2 Prot., datë 11.05.2023.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Kukës, referuar Memos me nr.1861/1 Prot., datë 26.12.2023.
- Monitorimi për avokatët e DHVA Sarandë, referuar Memos me nr.1858/2 Prot., datë 08.11.2023.
- Është realizuar procesi i monitorimit fillestar dhe i vazhdueshëm për ofruesit e ndihmës juridike dytësore që përbëjnë Listën e Avokatëve të Dhomave Vendore, duke konstatuar dhe vlerësuar cilësinë në ofrimin e shërbimit nga ana e secilit avokat, sipas IKV-ve të metodologjisë. Janë përcjellë rekomandimet përkatëse nga mbikëqyrja e ofrimit të shërbimit në lidhje me përshtatjen e zyrave për personat me aftësi të kufizuar dhe të moshuarve, në lidhje me mbajtjen e arkivit në mënyrë të unifikuar, etj. Rekomandimet janë të pasqyruara në formularët 4 *“Për vlerësimin e performancës për ndihmen juridike dytësore”* dhe 6 *“Për vlerësimin të strukturës organizative të ndihmës juridike dytësore”*.
- Raportet e Vlerësimi të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore për periudhën Janar-Dhjetor 2023 ka konkluduar me:
  - **Pagesën e ofruesve të ndihmës juridike dytësore, për 345 vendime gjyqësore, për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike dytësore.**
  - **28 Raporte Vlerësimi janë konstatuar për mospagesë, ndaj ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.**

## 5. Ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e ndihmës juridike

Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që çdo shtet duhet ta garantojë në mënyrë eficiente dhe efektive.

Ligji nr.111/2017, “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, ka si qëllim të sigurojë akses të barabartë në drejtësi përmes garantimit dhe funksionimit të sistemit të ndihmës juridike falas. Ky sistem garanton ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Në këtë ligj, përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, disa prej të cilave janë: Mbledhja dhe analiza e informacionit mbi dhënien e ndihmës juridike, organizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj; bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare, me Klinika Ligjore dhe me Organizata Jofitimprurëse me qëllim zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut.

### 5.1 Zhvillimi dhe pjesëmarrja në takime/aktivitete ndërgjegjësuere.

#### 5.1.1 Zhvillimi dhe pjesëmarrja e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në aktivitete/ takime.

Përgjatë vitit 2023 Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas ka organizuar dhe/ose ka qënë pjesëmarrëse në **30 takime/aktivitete ndërgjegjësuere**, të listuara në tabelën si vijon:

Nr.	Data	Aktiviteti/ Takimi
1	12.01.2023	Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas mori pjesë në takim të mbajtur nga Ministri i Drejtësisë, mbi realizimin e detyrave për vitin 2022 dhe vendosja e objektivave për vitin 2023.
2	27.01.2023	Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas, në bashkëpunim me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë, në kuadër të projektit “Fuqizimi i profesionalizmit të avokatëve në përfaqësimin dhe mbrojtjen e kategorive vulnerabel, përfituese të ndihmës juridike, me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor në proceset civile dhe penale” mbështetur nga programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD), zhvilloi një trajnim mbi legjislacionin e ndihmës juridike dhe problemet që lidhen me zbatimin e tij.
3	01.02.2023	Aktiviteti i shpërndarjes së çertifikatave të trajnimit fillestar të paraligjorëve.
4	22.02.2023	U zhvillua procedura e hedhjes së shortit për përgatitjen e listës dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative për vitin 2023.
5	07.03.2023	U mbajt ceremonia e shpërndarjes së çertifikatave për studentet që ndoqen praktikën 3 mujore të punës, të cilët kontribuan në dhënien e shërbimit të ndihmës ligjore falas pranë Klinikeve të Ligjit, Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.

6	Mars 2023	U nënshkrua në Durrës marrëveshja e bashkëpunimit midis Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.
7	27.04.2023	Drejtori i Përgjithshëm z.Ergys Qirici dhe punonjëset me trajnim të posaçëm pranë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier dhe Gjirokastrë, me pjesëmarrjen e koordinatorëve të UNDP kanë dhënë intervistë për News 24, Radio Televizioni Shqiptar dhe median lokale Radio Televizioni Gjirokastra, mbi shtrirjen dhe funksionimin e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, rastet e trajtuara dhe shërbimin e ofruar nga këto Qendra.
8	Maj 2023	Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, në bashkëpunim me Albania Foundation for Conflict Resolution, në kuadër të projektit “Zgjerimi dhe Fuqizimi i Sistemit të Ndërmjetësimit në Shqipëri” organzoi dy seminare, të mbajtura në Tiranë dhe në Shkodër me temë “Mbi mekanizmin e Referimit të Çështjeve në Ndërmjetësim”.
9	Qershor 2023	Nënshkrimi i marrëveshjeve për sigurimin e ambienteve pa kundërshpërblim, për hapjen e 6 Qendrave të Reja të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Tropojë, Përmet, Mat, Pukë, Kurbin dhe Kavajë.
10	07.07.2023	Drejtori i Përgjithshëm, z.Ergys Qirici mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar në Kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Ndërmjetësimit, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë.
11	Shtator 2023	Mbahet Ceremonia e shpërndarjes së “ <i>Certifikatave mirënjohje</i> ”, nga Ministri i Drejtësisë, z.Ulsi Manja, për Organizatat vendase dhe të huaja të shoqërisë civile, që kontribuojnë në Parandalimin e Krimeve të të Rinjve dhe Ndihmën Juridike Falas.
12	Shtator 2023	Drejtori i Përgjithshëm, z.Ergys Qirici, përfaqësuesja e programit ADA, përfaqësuesja e UNDP dhe gazetarja austriake Zj.K.Piker vizituan Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan.
13	Tetor 2023	Seminar mbi prezantimin e sistemit të Ndihmës Juridike Falas dhe kontributin e UNDP/ADA për konsolidimin e këtij sistemi, një grupi të magjistratëve Austriake që vizituan Shqipërinë.
14	Tetor 2023	Prezantimi i sistemit të Ndihmës Juridike Falas dhe roli i gruas sipërmarrëse në fushën e Ndihmës Juridike Falas, në workshopin e mbajtur në Shkup, Maqedoni e Veriut, përkrah shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor.
15	Tetor 2023	Pjesëmarrja e Drejtorit të Përgjithshëm në takimin me temë “ <i>Fëmijët që jetojnë në kushte vulnerabiliteti përfitojnë mbështetje ligjore falas</i> ”, organizuar nga OJF Shërbimi Ligjor Falas (TLAS).
16	Tetor 2023	Vizita në Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan, e Drejtorit të Përgjithshëm, përfaqësues nga zyra lokale dhe qendrore e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).
17	Tetor 2023	Leksioni i Hapur, pranë Departamentit të Drejtësisë, Universiteti Marin Barleti, mbajtur nga Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas.
18	Tetor 2023	Leksioni i Hapur, pranë Departamentit të Drejtësisë, Universiteti Epoka, mbajtur nga Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas.



19	Tetor 2023	Leksioni i Hapur, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Tiranës, mbajtur nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.
20	Nëntor 2023	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, përkrah përfaqësuesve të institucioneve të tjera zhvilloi Vizitën Studimore, të organizuar nga Expertise France, me qëllim shkëmbimin e praktikave dhe eksperiencave me institucionet kryesore që bëjnë të mundur funksionimin e Ndhmës Juridike Falas, në Francë.
21	Nëntor 2023	DNJF mbylli me sukses <i>“Trajnimin e Trajnerëve”</i> në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatëve të Shqipërisë, me mbështetjen e Agjencisë Austriake për zhvillim, si pjesë e projektit <i>“Zgjerimi i shërbimeve ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri”</i> .
22	Nëntor 2023	Me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, realizuam trajnimin <i>“Mbi Udhëzuesin e ri të komunikimit dhe pritjes së qytetarëve, pjesë e kategorisë së veçantë/vulnerabël nga specialistët e Qendrave të Shërbimit”</i> .
23	Nëntor 2023	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mori pjesë në konferencën shkencore me temë <i>“Society in transformation: challenges and opportunities”</i> (30 years of Sociology at the University of Tirana), organizuar nga Departamenti i Sociologjisë, Universiteti i Tiranës.
24	Nëntor 2023	Leksioni i Hapur, pranë Departamenti i Drejtësisë, Universiteti Mesdhetar, mbajtur nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.
25	Nëntor 2023	Leksioni i Hapur, pranë Departamentit të Drejtësisë, Universiteti Luarasi, mbajtur nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.
26	Dhjetor 2023	Drejtori i Përgjithshëm z.Ergys Qirici mori pjesë në ceremoninë e mbajtur nga Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja, si pjesë e skuadrës së Ministrisë së Drejtësisë që përmbylli me sukses Proçesin e Shqyrtimit Analitik të legjislacionit me BE-në ( <i>Screening</i> ).
6	<b>Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes</b>	Realizuar monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm i <b>10 qendrave të shërbimit</b> të ndihmës juridike parësore ( <i>Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Shkodër, Lushnje, Gjirokastrë, Fier</i> ) si dhe monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për avokatët e ndihmës juridike dytësore;	Realizuar monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm i <b>12 qendrave të shërbimit</b> të ndihmës juridike parësore ( <i>Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Shkodër, Lushnje, Gjirokastrë, Fier, Berat, Elbasan</i> ) si dhe monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për avokatët e ndihmës juridike dytësore;  Në proces: Zhvillimi i monitorimit fillestar për Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kukës dhe Korçë.	Realizuar monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm i <b>20 qendrave të shërbimit</b> të ndihmës juridike parësore ( <i>Lezhë, Pogradec, Vlorë, Dibër, Kukës, Korçë, Berat, Elbasan, Tiranë, Lushnjë, Durrës, Shkodër, Tropojë, Përmet, Pukë, Mat, Kavajë, Kurbin, Gjirokastrë dhe Fier</i> ) si dhe monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për avokatët e ndihmës juridike dytësore
7	<b>Zhvillimi i takimeve/aktiviteteve të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura</b>	<b>Zhvilluar 125 takime/aktivitete</b> ndërgjegjësuere të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura.  <b>Zhvilluar 5 intervista televizive</b> në televizionet lokale nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore;	<b>Zhvilluar 286 takime/aktivitete</b> ndërgjegjësuere të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura për vitin 2022.  <b>Zhvilluar 1 intervistë në radio</b> e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.  <b>Zhvilluar 10 intervista televizive</b> në televizionet lokale nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.	<b>Zhvilluar 364 takime/aktivitete</b> ndërgjegjësuere të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura për vitin 2023.  <b>Janë zhvilluar 5 intervista</b> nga Drejtori i Përgjithshëm, i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.  <b>Zhvilluar 16 intervista televizive</b> në televizionet lokale nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.
8	<b>Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse</b>	<b>Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse:</b>	<b>Vijuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse:</b>	<b>Vijuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse:</b>

		<p><b>UNDP/ADA</b> (mbështetja për Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore);</p> <p><b>OSFA/CLE</b> (mbështetja për angazhimin e paraligjorëve për zhvillimin e fushatave informuese në terren);</p> <p><b>OSCE</b> (mbështetja për zhvillimin e konferencës studentore: “Ndihma juridike e garantuar nga Shteti”);</p> <p><b>Euralius</b> (Publikimi i Manualit të Ligjit nr.111/2017, dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij).</p>	<p><b>UNDP/ADA</b> (mbështetja për Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore);</p> <p><b>OSFA/CLE</b> (mbështetja për angazhimin e paraligjorëve për zhvillimin e fushatave informuese në terren);</p> <p><b>Caritas Shqiptar</b> (mbështetja për zhvillimin e trajnimit të punonjësve që Qendrave);</p> <p><b>Expertise France Group ATD</b> (Barazia gjinore në aksesin në mundësitë ekonomike).</p> <p>Pjesëmarrje e DNJF në kuadër të zbatimit të projektit <b>JUSTAL</b> “Asistencë teknike për mbështetjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA II), për periudhën kohore 15 Qershor 2022- 14 Qershor 2024.</p>	<p><b>UNDP/ADA</b> (Mbështetja për Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore);</p> <p><b>Expertise France Group ATD</b> (Mbështetja e Expertise France në drejtim të kryerjes së një vizite studimore, shkëmbimi eksperiencash në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti).</p> <p><b>Mbështetja e Prezencës së OSBE në Shqipëri</b> në kuadër të zhvillimit të një trajnimit me punonjësit me trajnim të posaçëm të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, <b>mbi mënyrën e komunikimit/pritjes së qytetarëve pjesë e kategorisë së veçantë</b>, referuar nenit 11 të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.</p>
<b>9</b>	<b>Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet në nivel qendror, vendor institucionet e pavarura dhe gjykatat, në kuadër të referimit të rasteve dhe ndërgjegjësimit</b>	<b>Lidhur 9 marrëveshje bashkëpunimi</b> (me Organizatën Drejtësi Sociale; Shoqatën “Refleksione”; Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër; Shoqatën e Invalidëve të Punës; Shoqatën “Shqipëria”, Vlorë; Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Patos; Shoqatën “Shtëpi Shprese”; Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Berat; Organizatën	<b>Lidhur 17 marrëveshje bashkëpunimi</b> (me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Bashkinë Berat; Bashkinë Gjirokastrë; Bashkinë Kukës; Bashkinë Korçë; Caritasin Shqiptar; Universitetin Epoka; Këshillin e Qarkut Fier; Gjykatën e Rr. Gj. Elbasan; Gjykatën e Rr. Gj.Durrës; Gjykatën e Rr. Gj.Shkodër; Drejtorinë e Kujdesit Social Bashkia Lezhë; Organizatën “Vatra”; ISSH Gjirokastrë; Qendrën Evropiane; Qendrën	<b>Lidhur 11 marrëveshje bashkëpunimi</b> (me organizatën Centre for Legal Empowerment (CLE); Qendrën “Shërbimi Ligjor Falas”, Tiranë (TLAS); Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve (DHKN); Bashkinë Përmet; Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër; Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë; Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës; Gjykatën e Shkallës së Parë të

		<i>Jofitimprurëse MDG Berat).</i>	<i>për Fuqizimin Ligjor; Fondacionin “Joscelyn”);</i>	<i>Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;</i>
<b>10</b>	<b>Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore</b>	<b>Përfunduar trajnimi i detyrueshëm</b> të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore	<b>Zhvillimi i trajnimeve për 234 studentë</b> të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit si dhe zhvillimi praktikave pranë DNJF, Qendrës Tiranë, Vlorë dhe Shkodër <b>për 37 studentë.</b>  Përfunduar trajnimi i detyrueshëm i 14 ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore të cilët nuk i ishin nënshtruar trajnimit në vitin 2021.	<b>Për vitin 2023, janë trajnuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas 34 studentë</b> të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, të cilët u pajisën me vërtetim për pjesëmarrjen në trajnimin me temë “Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit Nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.  <b>Për vitin 2023, kanë zhvilluar praktikat e punës pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë, Elbasan dhe Shkodër 34 studentë,</b> të cilët u pajisën dhe me vërtetimet përkatëse.
<b>11</b>	<b>Raste të trajtuara, ndihma juridike parësore</b>	<b>8153</b> raste të trajtuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, platforma juristionline dhe numri i gjelbër 08001010.	<b>7616</b> raste të trajtuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, platforma juristionline dhe numri i gjelbër 08001010.	<b>7008 raste të raportuara<sup>5</sup></b> nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.  <b>7774 raste të raportuara</b> nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, <b>platforma juristionline dhe numri i gjelbër 08001010.</b>
<b>12</b>	<b>Raste të trajtuara, ndihma juridike dytësore</b>	<b>841</b> vendime me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore/ përjashtimin nga tarifat	<b>1030</b> vendime gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore/ përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.	<b>773</b> vendime gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore/ përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

<sup>5</sup> Rastet e evdinetuara nuk përfshijnë rastet e trajtuara nëpërmjet **Platformës Juristi Online dhe Nr. i Gjelbër.**

		dhe shpenzimet gjyqësore.		
13	<b>Realizimi Buxhetor:</b>  <b>Fonde Buxhetore të akorduara:</b>  <b>Fonde Jobuxhetore nga organizata :</b>	29.702.483 lekë  66.500.000 lekë  15.253.893 lekë	36.837.614 lekë  47.200.000 lekë  20.486.157 lekë	51.232.258 lekë  66.550.000 lekë  18.581.073 lekë
14	<b>Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara nga DNJF</b>	Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara me objekt ndihmën juridike dytësore gjatë vitit 2021 është 143 vendime.  Ndihmë juridike dytësore (pagesa avokatësh, ekspertësh dhe tarifa gjyqësore) me vlerë totale <b>prej 5,188,929 lekë.</b>	Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara me objekt ndihmën juridike dytësore për periudhën 2022 është 289 vendime.  Ndihmë juridike dytësore (pagesa avokatësh, ekspertësh dhe tarifa gjyqësore) me vlerë totale <b>prej 9.895.440 lekë.</b>	Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara me objekt ndihmën juridike dytësore për periudhën 2023 është 348 vendime.  Ndihmë juridike dytësore (pagesa avokatësh, ekspertësh dhe tarifa gjyqësore) me vlerë totale <b>prej 12.280.100 lekë.</b>

## 13. Plani i Punës Janar- Dhjetor 2024

### OBJEKTIVI I: GARANTIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Nr.	Masat/proçeset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjëse	Afate / komente
<b>1.1</b>	<b>Lidhja e marrëveshjes së re të bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe UNDP për vitin 2024</b>	<p>Ndërmarrja e procedurave në kuadër të lidhjes së marrëveshjes së re të bashkëpunimit me qëllim vijimin e mbështetjes së 8 (tetë) Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore për vitin 2024.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dakordësia mbi masat, aktivitetet, targetat si dhe planin financiar ;</li> <li>- Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit;</li> <li>- Dërgimi për nënshkrim pranë UNDP dhe MD;</li> <li>- Implementimi i marrëveshjes së re të bashkëpunimit.</li> </ul>	<p>Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore.</p> <p>Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse</p>	Shkurt - Mars 2024
<b>1.2</b>	<b>Administrimi i qendrave aktuale të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore</b>	<p>Mbarëvajtja e veprimtarisë së qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komunikimit ditor me punonjësit e qendrave;</li> <li>- Administrimit të të dhënave të shërbimit të ofruar;</li> <li>- Adresimit dhe përcjelljes së çdo problematike të punonjësve të qendrave;</li> <li>- Zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të promovimit të qendrave;</li> <li>- Mirëfunksionimit të qendrave përmes pajisjeve me mjetet e nevojshme logjistike.</li> <li>- Bashkëpunimit me institucionet e pushtetit qendror/vendor me qëllim marrjen e masave që masat që</li> </ul>	<p>Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore.</p>	Janar - Dhjetor 2024



		<p>Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore të ofrojnë të gjitha facilitetet e nevojshme, në përputhje me standardet e miratuara (<i>akses nga personat me aftësi të kufizuara, mundësimi i ambienteve private për çëshjet konfidenciale etj.</i>)</p> <p>Vlerësimi i performancës së QSHNJP nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimit dhe miratimit me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të indikatorëve të performancës së QSHNJP (<i>Numri i rasteve të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore; Numri i shkresave të hartuara nga Qendra në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike parësore; Mënyra e raportimit konform udhëzimit nr. 1/2019, të Ministrit të Drejtësisë; Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese/Bashkëpunimi me institucionet; Raportimi javor pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas; Cilësia e shkresave të hartuara nga Qendra etj.</i>)</li> <li>- Bashkëpunimit me pikat e kontaktit në institucionet ku janë vendosur QSHNJP në drejtim të vlerësimit individual të punonjësve sa i përket etikës në marrëdhëniet e punës, kolegjalitetit në punë dhe respektimit të orarit zyrtar nga punonjësit e qendrave;</li> <li>- Kryerja e vlerësimeve të QSHNJP në baza 6 mujore.</li> </ul>		Janar - Dhjetor 2024
1.3	<p><b>Kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të qendrave të hapura me mbështetjen e UNDP, pas përfundimit të marrëveshjes në Dhjetor 2024.</b></p>	<p>Hartimi i një raporti studimor mbi riorganizimin e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, pas përfundimit të marrëveshjes me UNDP në Dhjetor 2024, ku të evidentohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nevojat për punonjës shtesë, në rast të kalimit me buxhet shteti të të gjitha</li> </ul>	<p>Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore</p> <p>Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse</p> <p>Ministria e Drejtësisë</p>	Janar - Dhjetor 2024

		<p>QSHNJP që DNJF administron;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qendrat që propozohen të mbyllen në rast të mos sigurimit të mbështetjes financiare për punonjës shtesë;</li> <li>- Indikatorët e përdorur për evidentimin e qendrave që propozohen të mbyllen;</li> <li>- Evidentimin e Qendrave që propozohen të mbyllen.</li> </ul> <p>Dërgimi i raportit studimor Ministrisë së Drejtësisë me qëllim vlerësimin e propozimit përkatës dhe ndërmarrjen e masave për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Në rast pranimit të kërkesës për punonjës shtesë-</i> Miratimi i urdhrave për kalimin me buxhet shteti të 8 QSHNJP të mbështetura nga UNDP;</li> <li>- <i>Në rast refuzimi të kërkesës për punonjës shtesë-</i> Miratimi i urdhrave për QSHNJP që do të mbyllen si dhe miratimi i urdhrave për kalimin me buxhet shteti të QSHNJP të mbështetura nga UNDP për të cilat është vlerësuar vijimi i veprimtarisë.</li> </ul>		
1.4	<p><b>Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të QSHNJP nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve fillestare dhe vazhduese.</b></p>	<p><b>Shkresë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore</b> me lëndë: Përcjelljen e tematikave të evidentuara si të nevojshme për kryerjen e trajnimeve vazhduese në drejtim të forcimit të kapaciteteve;</p> <p><b>Administrimi i nevojave për trajnime vazhduese</b> të përcjella nga punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore dhe <b>përfshirja e tyre në programin e planifikimit të trajnimeve vazhduese.</b></p>	<p>Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.</p> <p>Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse</p> <p>Shkolla Shqiptare e Administratës Publike</p>	<p>Janar - Dhjetor 2024</p>

		<p><b>Shkresë DAP/ASPA me lëndë: Kërkesë për bashkëpunim</b> për miratimin e programit të planifikimit të trajnimeve vazhduese për vitin 2024, si dhe zhvillimin e trajnimeve, si detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 9 shkronja “g” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.</p> <p><b>Shkresë Organizatave Ndërkombëtare Mbështetëse</b> me lëndë: <i>Kërkesë për mbështetje për rritjen e kapaciteteve dhe aftësimin profesional të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore.</i></p> <p><b>Zhvillimi i trajnimeve vazhduese nga ASPA/Organizatave Ndërkombëtare Mbështetëse</b> në rast dakordësie të kërkeses për mbështetje.</p>		
1.5	<p><b>Autorizimi i organizatave jofitimprurëse në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndjekja e procesit të ndryshimit të VKM nr. 55/2019, sipas Matricës së Akteve, planifikuar për 4 mujorin e parë të vitin 2024.</li> <li>- Ndjekja e procedurës së autorizimit të organizatave jofitimprurëse sipas kritereve të reja të përcaktuara në VKM-në e ndryshuar;</li> <li>- Përfundimi i procedurës dhe shpërndarja e akteve të autorizimit;</li> <li>- Administrimi i të dhënave të shërbimit të ofruar nga organizatat jofitimprurëse të autorizuar;</li> <li>- Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të promovimit dhe ndërgjegjësimit.</li> </ul>	<p>Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore.</p>	<p>Janar-Prill 2024</p> <p>Maj-Shtator 2024</p> <p>Tetor 2024</p> <p>Janar-Dhjetor 2024</p> <p>Janar-Dhjetor 2024</p>
1.6	<p><b>Hapja e thirrjes për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë pas përfundimit të projekteve në proces.</b></p>	<p>- Shkresë Ministrisë së Drejtësisë me qëllim dakordësinë mbi afatin e hapjes së thirrjes për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar, në kushtet kur afati i autorizimit të organizatave përfundon në Shtator 2024.</p>	<p>Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore.</p> <p>Drejtoria e Financave, Arkivit dhe</p>	<p>Janar 2024</p>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me qëllim përcjelljen e regjistrit të organizatave që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike falas</li> <li>- Rishikimi i metodologjisë së vlerësimit të organizatave jofitimprurëse që përfitojnë financim, sipas prioriteteve të DNJF për vitin 2024.</li> <li>- Hartimi i Planit Vjetor të Financimit dhe publikimi i tij në faqen zyrtare të MD/DNJF</li> <li>- Hapja e thirrjes për financim (në varësi të vendimmarjes së MD dhe ndryshimeve në VKM nr. 55/2019);</li> <li>- Marrja pjesë në komisionin e vlerësimit dhe ankimit për financimin e OJF-ve</li> <li>- Ndërmarrja e procedurave për lidhjen e kontratave me Organizatat e shpallura fituese</li> </ul>	Shërbimeve Mbështetëse	<p>Janar 2024</p> <p><i>Në vijimësi, në varësi të hapjes së thirrjes</i></p> <p><i>Në vijimësi, në varësi të hapjes së thirrjes</i></p> <p><i>Në vijimësi, në varësi të hapjes së thirrjes</i></p> <p><i>Në vijimësi, në varësi të hapjes së thirrjes</i></p> <p><i>Në vijimësi, në varësi të hapjes së thirrjes</i></p>
1.7	<b>Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit</b>	<p><b>Përgatitja e një plani masash me synim rivitalizimin e Klinikave të ligjit</b> ku të përfshihen disa opsione:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nevoja për ndryshime në ligjin nr. 111/2017, ku të mundësohet garantimi i një fondit të veçantë nga Ministria e Arsimit për funksionimin e Klinikave Ligjore pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë;</li> <li>- Përcaktimi i një dispozite ligjore e cila i detyron IAL-të të ndërmarrin masat për funksionimin e Klinikave Ligjore;</li> <li>- Përcjelljen e nevojës për mbështetje të Klinikave Ligjore të Drejtorisë së Projekteve dhe Strategjive në Ministrinë e Drejtësisë.</li> </ul> <p>Ndërveprimi aktiv mes DNJF dhe Klinikave të Ligjit me të cilat kemi</p>	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore.	Mars 2024

		<p>lidhur marrëveshje bashkëpunimit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Trajnimit mbi ndihmën juridike për studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit;</li> <li>- Praktikave të punës për studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit;</li> <li>- Zhvillimit të aktiviteve të përbashkëta ndërgjegjësuere/informuese</li> </ul>		Janar-Dhjetor 2024
<b>1.8</b>	<b>Administrimi i plotë i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës juridike parësore.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbledhja dhe sistematizimi i të dhënave mbi ndihmën juridike parësore;</li> <li>- Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmën juridike parësore</li> <li>- Hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të analizës statistikore mbi ndihmën juridike parësore (analizë që hartohet çdo muaj)</li> </ul>	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.	Janar-Dhjetor 2024

## OBJEKTIVI 2: GARANTIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
<b>2.1</b>	<b>Sigurimi i shërbimit të avokatëve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lidhja e kontratës me avokatët për vitin 2024 si dhe publikimi i listës</li> </ul>	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndhmës Dytësore	Janar- Mars 2024
<b>2.2</b>	<b>Administrimi i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës juridike dytësore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbledhja dhe sistematizimi i të dhënave mbi numrin e vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike dytësore;</li> <li>- Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmën juridike dytësore për përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore;</li> <li>- Hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të analizës statistikore mbi</li> </ul>	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Janar- Dhjetor 2024

		ndihmën juridike dytësore (analizë që hartohet çdo muaj)		
<b>2.3</b>	<b>Ndjekja e vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore</b>	<p>- Komunikimi me Dhomat Vendore të Avokatisë në kuadër të caktimit të avokatit që do të ofrojë shërbimin e ndihmës juridike dytësore;</p> <p>- Ankimimi i vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga shpenzimet / tarifat gjyqësore referuar nenit 22 pika 9 e Ligjit 111/2017 “Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mund të ankimojë vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, nëse pretendon se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar. Në këtë rast zbatohen afatet dhe rregullat për ankimin e vendimeve përfundimtare, sipas dispozitave të legjislacionit procedural. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë”.</p>	Drejtoria Mbikëqyrjes e	Janar- Dhjetor 2024

### OBJEKTIVI 3: MONITORIMI I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE/DYTËSORE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
<b>3.1</b>	<b>Monitorimi i shërbimit të ofruar nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore</b>	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve	Drejtoria Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndhmës Dytësore e	Janar-Mars 2024
		Kryerja e monitorimeve tremujore për qendrat e ndihmës juridike parësore		Prill-Qershor 2024 Korrik-Shtator 2024 Shtator-Dhjetor 2024
		Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës		Janar-Mars 2024 Prill-Qershor 2024 Korrik-Shtator 2024 Shtator-Dhjetor 2024
<b>3.2</b>	<b>Monitorimi i shërbimit të ofruar nga</b>	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve	Drejtoria Mbikëqyrjes e dhe	Maj 2024

	<b>Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara të cilat përfitojnë financim nga buxheti i shtetit</b>	Kryerja e monitorimeve katër mujore për organizatat  Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës	Administrimit të Ndihmës Dytësore	Maj-Gusht 2024 Shtator-Dhjetor 2024  Maj-Gusht 2024 Shtator-Dhjetor 2024
<b>3.3</b>	<b>Monitorimi i shërbimit të ofruar nga Avokatët e ndihmës juridike dytësore</b>	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve  Kryerja e monitorimit fillestar për avokatët e rinj të ndihmës juridike dytësore  Kryerja e monitorimit të vazhdueshëm për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore  Hartimi i raporteve të monitorimit/Vlerësimi i performancës  Hartimi i raporteve të mbikëqyrjes dhe përcjellja e rekomandimeve përkatëse	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Janar 2024  Janar-Qershor 2024  Janar-Dhjetor 2024  Janar-Dhjetor 2024  Janar-Dhjetor 2024
<b>3.4</b>	<b>Hartimi i raporteve përmbledhëse të monitorimit</b>	Raport përmbledhës monitorimi për shërbimin e ndihmës juridike parësore;  Raport përmbledhës monitorimi për shërbimin e ndihmës juridike dytësore.	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Dhjetor 2024
<b>3.5</b>	<b>Kryerja e pagesave për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike</b>	Verifikimi i dokumentacionit sipas raportit të monitorimit  Fatura tatimore	Drejtoria e Financës	Janar-Dhjetor 2024

**OBJEKTIVI 4: NDËRVEPRIMI ME DONATORËT DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS**

<b>Nr.</b>	<b>Masat / proçeset e planifikuara</b>	<b>Aktivitetet dhe detyrat konkrete</b>	<b>Institucioni/Dr. Përgjegjës</b>	<b>Afate / komente</b>
<b>4.1</b>	<b>Ndërveprimi me UNDP në kuadër të projekteve të përbashkëta</b>	Raportim narrativ dhe financiar çdo katër mujor  Hartimi i faceform çdo katër mujor  Rakordimi me degën e thesarit për të fondet e UNDP	<b>Drejtoria e Zbatimit të Politikave</b>  <b>Drejtoria e Financës</b>	Mars-Dhjetor 2024

		<p>Ndërmarrja e masave të nevojshme për plotësimin e nevojave logjistike të qendrave të hapura me mbështetjen e UNDP;</p> <p>Ndërveprimi në kuadër të promovimit të qendrave përmes publikimit të spoteve informuese; materialeve të vizibilitetit etj.</p> <p>Ndërveprimi lidhur me aktivitete të përbashkëta me fokus krijimin e networkut ndërmjet ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe institucioneve të pushtetit vendor/qendror.</p>	<b>UNDP</b>	
<b>4.2</b>	<b>Ndjekja e proceseve të punës me donatorë të ndryshëm si OSCE, Agjencia Franceze për Zhvillim, JUSTAL etj.</b>	<p>- Evidentimi i nevojave për mbështetje;</p> <p>1. Kërkesë për mbështetje teknike për kryerjen e një analize mbi përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike falas-minimumi jetik në Shqipëri, rekomandim i KLSH;</p> <p>2. Kërkesë për mbështetje për kryerjen e një spoti publicitar informues mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe publikimin në një nga televizionet kombëtare;</p> <p>3. Kërkesë për mbështetje për rritjen e kapaciteteve dhe aftësimin profesional të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore, rekomandim i KLSH;</p> <p>4. Mbështetje për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Ndërinstitucional për Ndihmën Juridike me përfaqësues nga institucionet përgjegjëse për ofrimin e ndihmës juridike (Gjykatat, Prokuroria, MD, Dhoma e Avokatisë, Dhomat Vendore të Avokatisë, Aspa, etj.) për hartimin e një Strategjie Komunikimi etj.</p> <p>- Zhvillimi i takimeve në kuadër të bashkëpunimit;</p>	<p><b>DNJF</b></p> <p><b>UNDP</b></p> <p><b>OSCE</b></p> <p><b>Agjencia Franceze për Zhvillim</b></p> <p><b>JUSTAL</b></p>	<p>Janar - Dhjetor 2024</p> <p><i>Në varësi të projekteve të donatorët me</i></p>



- Ndërmarrja e procedurave të bashkëpunimit në rast dakordësie

**OBJEKTIVI 5: DHËNIA E KONTRIBUTIT DHE RAPORTIMI I DNJF NË KUADËR TË PROÇESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN/STRATEGJIVE**

Nr.	Masat / proçeset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
5.1	<p><b>Raportime në kuadër të proçesit të Integrimit Evropian dhe Konventave Ndërkombëtare/Strategjive</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP).</li> <li>- Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND)</li> <li>- Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK)</li> <li>- Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM)</li> <li>- Kontribut i DNJF në kuadër të angazhimit në Planin e Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (OGP)</li> <li>- Angazhimin i DNJF në kuadër të proçesit të Integrimit Evropian dhe Raportimeve Ndërkombëtare</li> <li>- Kontribut në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit IPA.</li> <li>- Kontributi i DNJF në CEPEJ “Dashboard Ëestern Balkans;</li> <li>- Kontribut i DNJF në kuadër të raportimit të Kapitullit 23.</li> <li>- Kontributi i DNJF në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-203</li> <li>- Kontribut i DNJF në kuadër të raportimit të Këshillit të Stabilizim Asociimit për Shqipërinë dhe përgatitjes së Pozicionit Kombëtar të Shqipërisë</li> </ul>	Drejtoria e Zbatimit të Politikave	Janar-Dhjetor 2024

- Kontribut në kuadër të monitorimit e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave ;
- Kontribut dhe anagazhim i DNJF në kuadër të OGP;
- Kontribut i DNJF për Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025.
- Kontribut në Strategjinë ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit për periudhën 2024-2030;
- Kontribut sa i përket Nënkomitetit Bashkimi Evropian–Shqipëri “Drejtesia, Liria dhe Siguria”.
- Kontribut i DNJF në kuadër të raportimit mbi kontributin e parë final për kapitullin 23 dhe Institucionet demokratike;
- Kontribut i DNJF në kuadër të raportimit mbi draftin e Pozicionit Negociues, në kuadër të procesit të hartimit të udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës;
- Kontribut i DNJF në kuadër të raportimit për Konventën e Këshillit të Evropës mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (Konventa e Stambollit);
- Kontribut i DNJF në kuadër të raportimit mbi draftin e Pozicionit Negociues, të Kapitullit 24, në kuadër të Bashkëpunimit Gjyqësor për çështje civile dhe penale;
- Kontribut i DNJF, në kuadër të Agjendës 2030 dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Kontribut i DNJF në kuadër të Konventës për të Drejtat e

		<p>Personave me Aftësi të Kufizuar (KDKPAK);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kontribut i DNJF në kuadër të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025.</li> <li>- Kontribut i DNJF në kuadër të SASPAC për raportimin e projekteve me financim të huaj.</li> </ul>		
<b>OBJEKTIVI 6: PROMOVIMI I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE</b>				
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
6.1	<b>Përgatitja dhe ndjekja e publikimeve të DNJF në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Facebook, instagram</b>	Ndjekje e procedurave të nevojshme me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve.	DNJF	Janar-Dhjetor 2024
6.2	<b>Përditësimi i faqes web të DNJF</b>	Përditësimi dhe publikimi i të dhënave më të fundit sipas rubrikave të mirëpërcaktuara.	DNJF	Janar-Dhjetor 2024
6.3	<b>Zhvillimi i takimeve promovuese/sensibilizuese/ edukimit ligjor të publikut</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi i një analize me qëllim forcimin dhe maksimizimin e impaktit në ndërgjegjësimin e publikut mbi sistemin e ndihmës juridike ku të përcaktohen komponentët ku duhet të zbatohet Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore në konceptimin e Kalendarit Vjetor të Aktiviteteve;</li> <li>- Hartimi i Kalendarit të Aktiviteteve për vitin 2024, duke u bazuar në komponentët dhe gjetjet e analizës</li> <li>- Konceptimi i një formati TIP regjistri raportimi ku të evidentohen të gjithë qytetarët të cilët kanë përfituar ndihmë juridike parësore si rrjedhojë e informimit përmes aktiviteteve ndërgjegjesuese/sensibilizuese të zhvilluara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës juridike Parësore, dhe përcjellja për zbatim Qendrave;</li> </ul>	<p>DNJF</p> <p>Ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore</p>	<p>Janar 2024</p> <p>Janar 2024</p> <p>Janar 2024</p> <p>Janar – Dhjetor 2024</p>

- Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe sesioneve të edukimit ligjor

### OBJEKTIVI 7: RAPORTIME MBI SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHETI

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
7.1	Përgatitja e raportimeve drejtuar Ministrit të Drejtësisë mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti <sup>6</sup>	- Hartimi i raportimeve mujore; 3 mujore; 6 mujore dhe vjetore drejtuar Ministrit të Drejtësisë;  - Hartimi i raportimeve të tjera drejtuar Ministrit të Drejtësisë në varësi të kërkesave	DNJF	Janar-Mars 2023  Prill-Qershor 2023  Korrik-Shtator 2023  Tetor-Dhjetor 2023
7.2	Trajtimi i shkresave nga institucione të ndryshme në kuadër të raportimit mbi ecurinë dhe progresin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti	Dhënia e informacionit mbi ecurinë dhe zhvillimet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti lidhur me kërkesat për informacion	DNJF	Janar-Dhjetor 2023

### OBJEKTIVI 8: MENAXHIMI DHE PLANIFIKIMI FINANCIAR I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
8.1	Vlerësimi i kostove dhe planifikimi i shpenzimeve të lidhura me dhënien e ndihmës juridike	Ndjekja, analizimi dhe planifikimi i shpenzimeve financiare mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.	Dr. Financave	Janar 2024
8.2	Menaxhimi i fondeve buxhetore për dhënien e ndihmës juridike	Menaxhimi i fondeve buxhetore të DNJF dhe hartimi i raportimeve financiare	Dr. Financave	Janar-Dhjetor 2024

### OBJEKTIVI 9 : RIALOKIMI DHE DETAJIMIN I FONDEVE TË BUXHETIT VJETOR RAPORTIME

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
-----	---------------------------------	----------------------------------	-----------------------------	-----------------

<sup>6</sup> Sipas përcaktimeve të Ligjit nr.111/2017 "Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti".

<b>9.1</b>	<b>Detajimi i fondeve të Buxhetit për vitin 2024</b>	Rialokimi i fondeve të papërdorura me financim nga donatorët sipas strukturave buxhetore si dhe sipas nevojave të institucionit	Drejtoria e Financës	Janar 2024
		Pasqyrimi në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike dhe shpallja në faqen zyrtare të APP dhe Institucionit	Komisioni i Prokurimit	Janar 2024
		Realizimi i likuidimit të detyrimeve të prapambetura me prioritet	Drejtoria e Financës	Janar - Dhjetor 2024

**HARTIMI I PAGESAVE TË PUNONJËSVE TË DNJF NGA STRUKTURAT E BUXHETIT TË SHETIT DHE NGA ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE**

<b>Nr.</b>	<b>Masat / proceset e planifikuara</b>	<b>Aktivitetet dhe detyrat konkrete</b>	<b>Institucioni/Dr. Përgjegjës</b>	<b>Afate / komente</b>
<b>9.2</b>	<b>Hartimi i dokumentacionit financiar, për pagat sigurimet dhe shpenzimet</b>	<p>Hartimi i pagesave të pagave të punonjësve të NDJF si dhe punonjësit e qëndrave të sponsorizuar nga OJF</p> <p>Hartimi i Urdhër Shpenzimeve për shpenzimet financiare të artikujve 600 dhe 601</p> <p>Deklarimi i sigurimeve shoqërore shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat</p> <p>Pasqyrimi në sistemin HRMIS të pagave të punonjësve</p> <p>Hartimi i listëprezencës së punonjësve</p>	Drejtoria e Financës	<p>Janar-Dhjetor 2024</p> <p>Janar-Dhjetor 2024</p> <p>Janar-Dhjetor 2024</p> <p>Janar-Dhjetor 2024</p>
<b>9.3</b>	<b>Urdhër Pagesat</b>	<p>Gjenerimi nga sistemi HRMIS i Urdhër Shpenzimeve</p> <p>Transferrat bankare sipas Bankave të nivelit të dytë</p> <p>Pasqyrimi i shtesave, ndalesave apo cdo vendim gjyqësor</p> <p>Sistemi AFMIS, paraqitja e dokumentacionit justifikues të shpenzimit dhe ngarkimi në sistem</p>	Drejtoria e Financës	Janar - Dhjetor 2024

**OBJEKTIVI 10: MIRËADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE REKRUTIMI I PUNONJËSVE**

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
10.1	Miratimi i numrit të Punonjësve për vitin 2024		Ministria e Drejtësisë	Janar 2024
10.2	Evidentimi i nevojave për kualifikimin e punonjësve	Evidentimi i kualifikimeve të punonjësve Hartimi i planit vjetor të zhvillimit profesional të BNJ	Drejtoria e Financës ASPA	Janar 2024
10.3	Vendet vakante	Evidentimi dhe raportimi i vendeve vakante në zbatim të strukturës së miratuar për institucionin  Shpallja e vendeve vakante ne Sitemin HRMIS për punonjësit me Status të Nëpunësit Civil  Percaktimi i përshkrimit të punës dhe percaktimi i kriterëve për kualifikim në procedurën e rekrutimit të punonjësve  Shpallja në faqen Zyrtare të DNJF për vendet vakante, Ngritja e Grupit të punës për pranimin ose skualifikimin e kandidatëve	DAP  Drejtoria e Financës  Burimet Njerëzore	Janar-Dhjetor 2024  Janar-Dhjetor 2024  Janar-Dhjetor 2024  Janar-Dhjetor 2024

**OBJEKTIVI 11: HARTIMI I RAPORTEVE FINANCIARE DHE ANALIZA E BUXHETIT**

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
11.1	Pasqyrat financiare për vitin 2023	Plotësimi i pasqyrave financiare për vitin 2022, sipas formatit standart të miratuar nga Ministria e Financës	Drejtoria e Financës	Mars 2024
11.2	Inventarët fizikë dhe kontabël	Kryerja e inventarëve fizik dhe kontabël për aktivet e institucionit	Drejtoria e Financës	Dhjetor 2024
11.3	Amortizimi i pajisjeve	Amortizimi i pajisjeve objekt inventari të DNJF-së	Drejtoria e Financës	Dhjetor 2024

		Pasqyrimi i vlerave në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor paraardhës.		
--	--	---	--	--

**HARTIMI I REGJISTRIT TE RISKUT, FORMULARET E VETËVLERËSIMIT SI DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN**

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
11.4	Hartimi i regjistrit te riskut	Ngritja e grupit te punës për hartimin e regjistrit të riskut	Grupi i punës Drejtoria e Financës	Janar 2024
11.5	Hartimi i formularit te vetëvlerësimit per institucionin	Hartimi i formualrit te vetevlerësimit per periudhen janar- Dhjetor 2022 dhe përcaktimi i performancës së institucionit	Drejtoria e Financës Grupi i punës	Janar 2024

**RAPORTIME MBI PËRDORIMIN E FONDEVE TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE**

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
11.6	Dakordësimi mbi financimin e QSHNJP për periudhën Mars-Dhjetor 2024.	Evidentimi i nevojave për bazë materiale të qendrave  Evidentimi i nevojave për burime njerëzore  Evidentimi i nevojave për zhvillimin e monitorimeve të Qendrave	Drejtoria e Financës	Shkurt 2024
11.7	Raportimi Financiar "FaceForm"	Likujdimi i veprimtarisë financiare me fondet e dakordësuara në marrëveshjen e bashkëpunimit.  Hartimi i raporteve financiare përmbledhëse duke evidentuar plotësimin e nevojave.  Kuadrimi me UNDP mbi përdorimin e fondeve dhe dokumentacionin justifikues.	Drejtoria e Financës	Shkurt-Dhjetor 2024

**OBJEKTIVI 12: PROPOZIM PËR NDRYSHIMIN E STRUKTURËS SË DNJF, NË FUNKSION TË SHTIMIT TË NUMRIT TË PUNONJËSVE TË QSHNJP**

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
-----	---------------------------------	----------------------------------	-----------------------------	-----------------

12.1	Analizë mbi funksionimin e QSHNJP dhe nevojave për burime njerëzore.	Kryerja e një studimi gjeografik mbi mbulimin territorial me shërbimin e ndihmës juridike parësore.  Vlerësimi i impaktit të hartës së re gjyqësore.	Drejtoria e Financës  Drejtoria e Zbatimit të Politikave	Janar 2024
12.2	Propozim për ndryshim strukture.	Përcaktimi i numrit për punonjës për qendër duke ju referuar numrit të popullsisë për qendër.  Përlllogaritja e kostos financiare dhe efektet që do të sjellë kjo kërkesë në buxhetin e vitit 2024.	Drejtoria e Financës  Drejtoria e Zbatimit të Politikave	Mars 2024

### 13.1 Risi për vitin 2024

- **Dixhitalizimi i sistemit të marrjes së të dhënave në kohë reale** për ndihmën juridike parësore nga Qendrat e Ndihmës Juridike Parësore, si dhe Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë, në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore, realizimi i të cilit do të bëhet nga donatori UNDP.
- **Në kuadër të procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të tokave bujqësore, të përfituara me ligjin nr.7501/1991**, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas do të lehtësojë procesin duke filluar nga rishikimi i tarifave të përgjithshme, ofruar pro bono nga noteret etj, deri në ndihmën juridike parësore për dhënien e këshillimit, orientimit dhe përgatitjes së dokumentave duke vënë në lëvizje administratën qendrore/lokale dhe pse jo dhe ndihmë juridike dytësore për subjektet që janë kategori të Ligjit. nr.111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”. Për këtë qëllim, për qarkun Shkodër si projekt pilot, me kontrata të përkohshme pune do të shtohen dy punonjës për Qendrën e Ndihmës Juridike të Shkodrës dhe një punonjës shtesë për Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike te Pukës.
- **Nga 1 Janari 2024 do të nisë zbatimi i tatimit mbi të ardhurat prej 15% dhe 23% për vetë punësuarit, personat fizike tregtare në kuptim të Kodit Civil dhe shërbimeve dhe profesioneve të lira.** Avokatë/ekspertë, sipas parashikimeve në vendimin Nr.753, datë 20.12.2023, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Kjo gjë do të kërkoj rishikimin e udhëzimit të përbashkët ndërmjet Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë nr.18/2020, duke bërë një analizë për rishikimin e tarifave për shërbimin e ofruar. Nëse kërkohet shërbim cilësor nga avokatët e listës së ndihmës juridike dhe ekspertët tarifatur duhen rishikuar dhe rritur masa e tyre.